



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI ■ FAQE 4-5

# VLERAT E UÇK-së NUK MUND T'I BALTOSË ASKUSH

Ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se vlerat e UÇK-së janë të arta dhe ato nuk mund t'i baltosë askush. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vlerat e luftës çlirimtare janë krijuar me shekuj dhe ato do të shkëlqejnë çdoherë.

Krasniqi ka theksuar se institucionet e Kosovës, nëse nuk frymëzohen nga vlera e Lëvizjes Kombëtare për Çlirim, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe komandanti i saj legjendar, nuk mund ta realizojnë e finalizojnë shtetndërtimin. Në këtë intervistë Krasniqi ka folur edhe për Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se asnjë proces që bazën e ka në dëshmitë e rrejshme të Shërbimit të Sigurimit të Serbisë, siç ishin dëshmitë e raportit të Dick Martit, nuk mund t'i dëmtojë vlerat që ka krijuar UÇK-ja



KOSOVA KA NISUR MANIFESTIMIN E 22-VJETORIT TË "EPOPESE SË UÇK-SË"

## "Epopeja e UÇK-së" ndryshoi politikën dhe historinë e Kosovës

Në 22-vjetorin e "Epopesë së UÇK-së" liderët institucionalë kanë thënë se rezistenca e Adem Jasharit dhe familjes së tij ndryshoi politikën dhe historinë e shqiptarëve të Kosovës. Ata kanë deklaruar se sakrificat e Jasharëve ka zgjuar ndërgjegjen shqiptare duke i mobilizuar ata. Në nderim të heroizmit të kësaj familje është mbajtur seancë solemne parlamentare, kurse në Kazermën "Adem Jashari" kanë parakaluar ushtarët e FSK-së e në kompleksin memorial në Prekaz janë bërë homazhe ■ FAQE 6-7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

**ADEM JASHARI  
ME FAMILJE E NDRYSHOI  
EPOKËN HISTORIKE** F. 11

Akademik  
prof. dr. Hakif  
BAJRAMI



### AKTUALE



**KOSNETTI INFORMOHET RRETH  
SITUATËS SË KOMUNITETEVE  
JOSHUMICË NË KOSOVË** F. 3

**"ISA BOLETINI" FURNIZOHET  
ME ENERGJI ELEKTRIKE  
NËPËRMJET PANELEVE SOLARE** F. 5

### EKONOMI

**MBI 67 MIJË PERSONA  
VIZITUAN HOTELET E KOSOVËS  
NË TREMUJORIN E FUNDIT  
TË 2019-s** F. 8

**DOGANA RRIIT TË HYRAT PËR  
11 PËR QIND** F. 9

### KULTURË

**MKRS E UNDP TË GATSHME PËR  
BASHKËPUNIM NË PROJEKTE  
TË RINISË E TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE** F. 5

### SPORT

**VETËM HUMBJA E  
PAPRANUESHME PËR KOSOVËN  
KUNDËR RUSISË** F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijibiznesi.com](http://www.kolegijibiznesi.com)  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta letër Brukselit: Mos ndihmoni gërryerjen e demokracisë, vendi në situatë politike dramatike

**TIRANË, 5 MARS** - Një ditë pasi komisioni Evropian propozoi çeljen e negociatave mes BE-SË dhe Shqipërisë, presidenti Ilir Meta i ka dërguar një letër me doza të forta shqetësimi në adresë të komisionarit për fqinjësinë dhe zgjerimin Oliver Varhelyi. Presidenti paralajmëron thellimin e krizës e politike duke theksuar se Shqipëria është duke kaluar një situatë dramatike politike. Kjo letër e presidentit Ilir Meta, që disponohet ekskluzivisht nga Top

Channel nis me besimin e kreut të shtetit se rekomandimi komisionit, do të përkrahet nga vendet anëtare. Presidenti nuk pajtohet me gjetjet e shkruara nga Komisioni Evropian.

"Nuk mund ta fsheh keqardhjen në lidhje me fotografimin e fakteve lidhur me procesin e krijimit të Gjykatës Kushtetuese për të cilën thoni: 'Ka një mosmarrëveshje në lidhje me të fundit anëtarë të nominuar si pasojë e një interpretimi të procedurave të emërimit nga

Presidenti Republikës'". Ka thënë Meta. Padiskutim ka një mosmarrëveshje, në lidhje me procedurën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, por kjo vjen nga interpretimi i ndryshëm prej shumicës qeverisëse e cila tenton të kapë Gjykatën Kushtetuese të vendit duke e shtuar këtë krizë sui generis në Shqipëri.

Letra e presidentit, mbërritur në Bruksel, vijon me një tjetër koment për shumicën socialiste për sa i përket radhës së zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues.



"Shumica publikisht ka spekuluar për të përfituar mbështetje të plotë nga BE-ja duke miratuar masa legjislative antikushtetuese përfshi këtë ligj. Kam kërkuar të di pozicionin zyrtar të parla-

mentit për këtë çështje, por kam hasur në heshtje përballë këtyre akuzave", ka thënë Meta. Katalogu i ankesave të presidentit vijon edhe me misionin e EURALIUS në Tiranë.

## Shqipërisë mund t'i shtohet kushte të reja për hapjen e negociatave

Hans Joachim Falenski, këshilltar i grupit parlamentar CDU/CSU për çështje të politikës së jashtme, dhe një nga njohësit më të spikatur të gjendjes politike në Shqipëri, tha të martën se ka gjasa që Shqipërisë t'i shtohen edhe kushte të tjera, një ose dy, përveç nëntë kushteve të caktuara nga Bundestagu



presidenti Ilir Meta, e vuri theksin te kushti i vendosur nga Bundestagu për gjykatësit dhe prokurorët që nuk e kanë kaluar vettingun. "Bundestagu ka kërkuar që ata të ndiqen penalisht, por deri tani nuk po ndiqet asnjë, çka është komplet e papranueshme", tha ai. Akoma më "skandaloze" ai e quajti zvarritjen që po bëhet në lidhje me akuzën për blerje votash. "Ne po shohim se dosjet po shtyhen sa andej-këndej nga Dibra në Tiranë. Askush nuk dëshiron ta prekë "pataten e nxehtë", tha Falenski, megjithëse në fakt përgjegjës për këtë është vetëm SPAK-u. Sipas tij, gjasat janë të mira që të merret një vendim për çeljen e negociatave ose në fund të marsit, ose në maj, në Samitin e Zagrebit. Pritet që konferenca e parë ndërministrorë të bëhet në fund të këtij viti, por sipas Falenskit, vetëm nëse janë miratuar dy parakushtet e vendosura nga Bundestagu: Fillimi i reformës zgjedhore dhe vënia në punë e Gjykatës Kushtetuese. (dw).

**PRISHTINË, 5 MARS** - Këshilltari i CDU/CSU-së Hans Joachim Falenski, thotë se derisa Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut po presin në fund të marsit një "po" për çeljen e negociatave, ka gjasa që kushtet për Shqipërinë të shtohen. Komisioni i BE-së sërish rekomandoi çeljen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Vendimi pritet të merret në samitin e rregullt të krerëve të shteteve dhe qeverive të BE-së, në fund të marsit. Por cilat janë gjasat që kësaj here vendimi, tashmë i shtyrë disa herë që prej vitit 2018, të jetë pozitiv? Hans Joachim Falenski, këshilltar i grupit parlamentar CDU/CSU për çështje të politikës së

jashtme, dhe një nga njohësit më të spikatur të gjendjes politike në Shqipëri, u shpreh të martën në një panel diskutimi në ambientet e Parlamentit gjerman, se ka gjasa që Shqipërisë t'i shtohen edhe kushte të tjera, një ose dy, përveç nëntë kushteve të caktuara nga Bundestagu. Sipas Falenskit, njëri nga kushtet do të ishte luftimi i kriminalitetit të drogës, një problem që, siç tha eksperti kristiandemokrat, është bërë shkak kryesor për veton e vendeve të ulëta ndaj çeljes së negociatave me Shqipërinë. Falenski tha se aktualisht grupi parlamentar CDU/CSU po përpiqet t'ia mbushte mendjen kolegëve nga vendet ulëta që të jepnin po-në e tyre për Shqipërinë.

Hans Joachim Falenski, i cili është një nga këshilltarët e vjetër dhe me shumë influence në politikën e Bundestagut ndaj Shqipërisë, u shpreh pozitivisht për ndërtimin e SPAK-ut dhe institucioneve ndihmëse të tij. Por nga ana tjetër, ai kritikoi ecurinë e ngadalshme të vënies në funksionim të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së

Lartë. Falenski e vuri theksin te fakti që korrupsioni i nivelit të lartë po luftohet në mënyrë të pamjaftueshme. "Gjashtë dënime dhe 12 arrestime. Kjo është komplet e papranueshme, duke pasur parasysh situatën", tha ai. Falenski, i cili në fund të muajit të shkurt ndodhej në Shqipëri për të marrë një dekoratë nga

## Kasami: ShBA-ja përkrah koalicionin LSDM – BESA

**SHKUP, 5 MARS** - Nëse përvojat e deritanishme tregojnë se në politikën maqedonase asgjë nuk është e rastësishme, atëherë tajmingu i takimit në ShBA mes liderit të Besës, Bilall Kasami dhe ndihmës sekretarit shtetëror për Evropë dhe Euroazi, ambasadori Filip Riker para vetëm 30 ditëve para mbajtjes së zgjedhjeve në vend, merr një kuptim. Kasami në FB profilin e tij pub-

likoi fotografi dhe video nga vizita në Departamentin e Shtetit ku siç thotë, i ka informuar aleatët amerikanë për ndodhitë e fundit në vend, gjegjësisht për koalicionin parazgjedhor mes Besës dhe LSDM dhe ka marrë vlerësime pozitive nga diplomatë, ka njoftuar Zhurnal. Bilall Kasami i cili po qëndron për vizitë në Uashington ka theksuar se SHBA-ja ka shprehur

mbështetje të fuqishme për koalicionin BESA-LSDM. Kasami thekson se gjatë takimit me ndihmës sekretarin amerikan të Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, ambasadorin Philip T. Reeker ka pranuar vlerësime pozitive për koalicionin e arritur mes LSDM dhe Lëvizjes Besa. Ai shtoi se koalicioni LSDM-BESAË është garanci për orientimin euro-atlantik të Maqedonisë së Veriut.



# Kurti numëron sukseset e qeverisë, Veseli ia numëron dështimet

**EPOKA E RE**      **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 5 MARS** - Lideri opozitar, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka dhënë të enjten një vlerësim për një muaj të punës së qeverisë Kurti. Ai ka thënë se në tridhjetë ditë të qeverisë Kurti zhurma dhe arroganca janë bërë mjete për ta arsyetuar mospunën. “Thuhen shumë fjalë vetëm për t’i ikur përgjegjësisë para qytetarëve. Por, qeveritë e politikanët maten me punë dhe jo me fjalë. Zvogëlohet numri i zëvendësministrave, por pakuptueshëm rritet numri i këshilltarëve politikë. Bëhen shkarkime pa procedura, ngarkohen me detyra publike familjarët dhe militantët. Në politikën e brendshme papërgjegjësi, kurse në të jashtmen rrezikshmëri”, ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka shtuar se në vend që Kosovës t’i ofrohet siguri dhe forcim në marrëdhëniet

ndërkombëtare, po ndodh e kundërta. “Kërcënim dhe dobësim të marrëdhënieve me ShBA-në. Nervozizëm në marrëdhëniet me Shqipërinë e shprehje e vullnetit të mirë me Serbinë”, ka thënë Veseli, duke shtuar se për një muaj qeverisje, dy çnjohje të pavarësisë së Kosovës. “Kjo është pasqyra e këtij njëmuajori qeverisës, zhurmë, rrezik dhe pasiguri. Kosova meriton më mirë”, ka deklaruar lideri i PDK-së, Kadri Veseli. Një ditë më parë kryeministri Albin Kurti ka treguar për rezultatet e arritura për një muaj të qeverisë që drejton. Kurti ka thënë se qeveria nën drejtimin e tij mori shumë vendime të mira e të rëndësishme. Ai ka përmendur disa prej tyre. “U përgjysmuan pagat e kryeministrit, zëvendëskryeministrave, ministrave, zëvendësministrave dhe stafit të tyre, por jo edhe pagat në sistemin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese. U shkarkuan shtatë koordinatorë nacionalë. U emërua Komiteti



për Partneritet Publiko-Privat, në përbërje të të cilit janë pesë ministra. U aprovua Nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e ‘Marrëveshjes për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimin në të hyra dhe kapital’ në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Finlandës dhe, gjithashtu, me Mbretërinë e Holandës. U ndanë mjete

financiare në shumë prej 29,809.10 eurosh për projektin e GIZ-it, fonde që janë dhënë prej tij për mbështetjen e refugjatëve nga Republika e Shqipërisë gjatë qëndrimit në parkun inovativ të Biznesit në Prizren, me rastin e tërmetit. U aprovua mbështetja financiare për shmangien e dëmeve nga fatkeqësia natyrore e stuhisë së fuqishme në komunën e Pejës dhe të Istogut. Sipas raportit të komisionit, dëmet arrijnë

shumën prej 433 mijë eurosh”, ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në “Facebook”. Kurti si sukses ka përmendur edhe shkarkimet e bordeve në Telekomin e Kosovës, në “Infrakos” dhe në ndërmarrjen “Trepça”. “U shfuqizua vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për pagat e ish-ministrave e ish-zëvendësministrave pasi ata përfundojnë mandatin. Sekretarët e përgjithshëm nga ministratë e prekura, nga riorganizimi që zvogëloi numrin e ministrave, kaluan në listën tepërcë sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se ministrat janë duke bërë punë të palodhshme dhe të madhe. “Disa prej vendimeve që kanë marrë ata janë: Shfuqizimi i vendimeve të emërimeve të 14 konsujve nëpër botë, anulimi i tenderit 110 milionësh i autostradës Prishtinë-Gjilan i shpallur pa miratim buxhetor dhe anulimi i ndërtimit të lagjes pranë liqenit të Badovcit”, ka thënë Kurti.

# Kosnetti informohet rreth situatës së komuniteteve joshumicë në Kosovë



**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Ministria e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Emilija Rexhepi, është takuar të enjten me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, drejtoreshën e USAID-it, Lisa Magno dhe stafin politik, me të cilët ka biseduar lidhur me situatën aktuale në Kosovë, sigurinë, situatën e komuniteteve joshumicë, orientimet e qeverisë së re dhe rëndësinë e vazhdimit të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ministria Rexhepi ka falënderuar ambasadorin Kosnett për vizitën, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes dhe ndihmës që Shtetet e Bashkuara po i ofrojnë shoqërisë së Kosovës dhe të gjithë popujve të Kosovës në mënyrë të barabartë. “Në mandatin tim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

do të përpiqet t’i mbështesë qeveritë lokale sa më shumë që të jetë e mundur, ta përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e tyre, situatën në terren në secilën prej 38 komunave, me fokus në komunat shumetnike, gjithnjë në të mirë të qytetarëve tanë”, ka thënë ministria Rexhepi gjatë bisedës me ambasadorin. Në takim u diskutua edhe për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, respektimin e përdorimit të gjuhëve në të gjitha komunat, ofrimin e llojeve të ndryshme të mbështetjes nga USAID-i si dhe për krijimin e hapësirës për investimet amerikane në Kosovë. Ambasadori Kosnett ka theksuar gatishmërinë e Ambasadës së ShBA-së për të mbështetur çdo iniciativë që kontribuon në një jetë më të mirë në Kosovë.

## Hulumtimi dhe inovacioni, dy fusha me rëndësi të madhe për Kosovën


**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka pritur të enjten në takim ushtruesin e detyrës së presidentit dhe dekanin e RIT Kosova (A.U.K), Kamal Shahrabi, me bashkëpunëtorë, me të cilin ka

biseduar rreth bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe në atë të hulumtimit dhe inovacionit. Dekani Shahrabi e informoi ministrin Bajrami me punën që po bën RIT Kosova për forcimin e komponentit të inovacionit dhe planet që kanë

për ta rritur interesimin e nxënësve të shkollave të mesme që të studiojnë fushat e STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë). Ministria Bajrami e falënderoi dekanin Shahrabi për punën që po bën në vendin tonë RIT Kosova dhe për arsimimin cilësor që po ua ofron të rinjve tanë. Ajo theksoi se hulumtimi dhe inovacioni janë dy fusha me rëndësi të madhe për Kosovën dhe zhvillimi i tyre është edhe synim i Qeverisë së Kosovës, prandaj u shpreh e gatshme për bashkëpunim me RIT Kosova.



Ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka thënë se vlerat e UÇK-së janë të arta dhe ato nuk mund t'i baltosë askush. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se vlerat e luftës çlirimtare janë krijuar me shekuj dhe ato do të shkëlqejnë çdoherë. Krasniqi ka theksuar se institucionet e Kosovës nëse nuk frymëzohen nga vlera e Lëvizjes Kombëtare për Çlirim, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe komandanti i saj legjendar, nuk mund ta realizojnë e finalizojnë shtetndërtimin. Në këtë intervistë Krasniqi ka folur edhe për Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se asnjë proces që bazën e ka në dëshmitë e rrejshme të Shërbimit të Sigurimit të Serbisë, siç ishin dëshmitë e raportit të Dick Martit, nuk mund t'i dëmtojë vlerat që ka krijuar UÇK-ja



FLET PËR “EPOKËN E RE”, JAKUP KRASNIQI

# VLERAT E UÇK-së NUK MUND T'I BALTOSË ASKUSH

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 MARS** - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se luftën çlirimtare nuk mund ta baltosë askush. Ai ka deklaruar se vlerat e UÇK-së janë krijuar me shekujt dhe ato do të shkëlqejnë çdoherë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Krasniqi ka thënë se asnjë proces që bazën e ka në dëshmitë e rrejshme të Shërbimit të Sigurimit të Serbisë nuk mund t'i dëmtojë vlerat që ka krijuar UÇK-ja. “Ajo Gjykatë Speciale e dëmton të sotmen e të ardhmen e kombit e të shtetit

tonë! I kanë shërbyer kukuvajkat e vajtojsat që i kanë amnistuar armiqtë e kombit që me dekada ishin e janë në shërbim të armiqve të kombit. Natyrisht, kësaj gjykate i kanë shërbyer dhe i kanë shërbyer shumë edhe kundërshtarët e UÇK-së brenda e jashtë Kosovës. Një shërbim të tillë, të keq vendit, ia bënë edhe institucionet e larta të shtetit, si Kuvendi dhe jo vetëm ai! Një gjë dihet: Ari mund të baltoset, por ai kudo që bie e ruan shkëlqimin e vet”, ka thënë Krasniqi.

Ai ka vlerësuar se vlerat e UÇK-së janë ideali për liri dhe shteti që gëzojmë sot. “Vlerë e UÇK-së është ideali për liri, është

pavarësia, është shteti që e kemi e po e gëzojmë qytetarët e Kosovës. Nuk mund të respektohet UÇK-ja pa e respektuar shtetin e së drejtës që është krijesa më e natyrshme e luftës çlirimtare. Institucionet e Kosovës, nëse nuk frymëzohen nga vlera e lëvizjes kombëtare për çlirim, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe komandanti i saj legjendar, nuk mund të realizojnë e finalizojnë shtetndërtimin”, ka thënë Krasniqi.

Ish-zëdhënësi i UÇK-së ka treguar se pas “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” në Prekaz, pas 5, 6 e 7 marsit 1998, kanë ndryshuar në

mënyrë të rrufeshme rrjedhat e mobilizimit e të masivizimit të kombit për luftën çlirimtare. “Gjithçka që ka ndodhur nga atëherë e deri më sot, burimin e ka pasur dhe e ka në Prekazin e Adem Legjendarit. Shkurt, liria, pavarësia e shteti ynë aty i kanë themelet e ngritjes. Kushdo që këto vlera kombëtare tenton t'i kërkojë diku tjetër, ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse tregojnë përralla me shumë mbretër”, ka thënë Krasniqi.

**“Epoka e re”:** Z. Krasniqi, Kosova ka nisur shënimin e manifestimit tradicional “Epopeja e UÇK-së”, e cila përkujton sakrificën e

jashtëzakonshme të Jasharëve. Cili ka qenë ndikimi i 5, 6, dhe 7 marsit të vitit 1998 në rrjedhat e historisë?

**Krasniqi:** Duhet të themi se deri atëherë UÇK-ja ishte emri i një guerilje të kufizuar në disa rrethe të vogla veprimi. Pas Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prekaz, pas 5, 6 e 7 marsit 1998 kanë ndryshuar në mënyrë të rrufeshme rrjedhat e mobilizimit e të masivizimit të kombit për luftën çlirimtare, mobilizimi i së cilës pengohej nga ata që duhej të ndihmonin, por se ndihmuan e më shumë e sabotuan. Pas 5, 6 e 7 marsit lufta nuk kishte kthim prapa dhe nuk kishte forcë politike, as



është lehtë për institucionet e sotme që ta përmbushin amanetin e Jasharëve legjendarë.

**“Epoka e re”:** *Republika e Kosovës tashmë ka shënuar 12-vjetorin e pavarësisë. A po respektohen sa duhet nga institucionet dhe shoqëria e Kosovës vlerat e UÇK-së?*

**Krasniqi:** Vlerë e UÇK-së është ideali për liri, është pavarësia, është shteti që e kemi e po e gëzojnë qytetarët e Kosovës. Nuk mund të respektohet UÇK-ja pa e respektuar shtetin e së drejtës që është krijesa më e natyrshme e luftës çlirimtare. Institucionet e Kosovës, nëse nuk frymëzohen nga vlera e Lëvizjes Kombëtare për Çlirim, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Komandanti i saj Legjendar, nuk mund ta realizojnë e finalizojnë shtetndërtimin.

**“Epoka e re”:** *Gjatë kësaj kohe, jo rrallë, janë sulmuar në mënyra të ndryshme vlerat e luftës së çlirimtare. Si i keni parë këto veprime?*

**Krasniqi:** Në botë kudo ka antivlera më shumë sesa vlera, sesa integritet e dinjitet, prandaj vlera është në shënjestër të frikacakëve që u është prishur rehatia që e kishin nën sundimin e huaj. Prandaj, vlerat kudo sulmohen nga antivlerat e lirisë e të çlirimt. Edhe ari në natyrë është në pakicë në krahasim me shumë metale të tjera të ndryshkura. Por, ndryshku gjithnjë rrinë larg arit!

brenda e as jashtë vendit, që mund ta ndalte atë. Gjithçka që ka ndodhur nga atëherë e deri më sot, burimin e ka pasur dhe e ka në Prekazin e Adem Legjendarit. Shkurt, liria, pavarësia e shteti ynë aty i kanë themelet e ngritjes. Kushdo që këto vlera kombëtare tenton t'i kërkojë diku tjetër, ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse tregojnë përralla me shumë mbretër.

**“Epoka e re”:** *Gjatë këtyre 20 vjetëve, sa kanë bërë institucionet e Kosovës për sakrificën e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij?*

**Krasniqi:** Familja e komandantit legjendar dhe ai vetë nuk ka rënë për veten e tyre, por kanë rënë për lirinë e mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Kosovës, ka rënë për çlirimin e bashkimit e kombit. Puna e institucioneve shihet sa kanë arritur të krijojnë siguri, zhvillim e prosperitet për kombin. Atë që e kanë bërë për kombin, e kanë bërë edhe për Jasharët e rinj. Prandaj, nuk

**“Epoka e re”:** *Deri më tani Gjykata Speciale ka dorëzuar qindra ftesa për intervistim për ish-luftëtarët e UÇK-së. A mund ta dëmtojë ky proces luftën e lavdishme çlirimtare të Kosovës?*

**Krasniqi:** Jo, asnjë proces që bazën e ka në dëshmitë e rrejshme të Shërbimit të Sigurimit të Serbisë, siç ishin dëshmitë e raportit të Dick Martit, nuk mund t'i dëmtojë vlerat që ka krijuar UÇK-ja. Ato janë vlera që i kanë krijuar shekujt. Ajo Gjykatë Speciale e dëmton të sotmen e të ardhmen e kombit e të shtetit tonë! I kanë shërbyer kukuvajkat e vajtojsat që i kanë amnistuar armiqtë e kombit që me dekada ishin e janë në shërbim të armiqve të kombit. Natyrisht, kësaj gjykate i kanë shërbyer shumë edhe kundërshtarët e UÇK-së brenda e jashtë Kosovës. Një shërbim të tillë, të keq vendit, ia bënë edhe institucionet e larta të shtetit, si Kuvendi dhe jo vetëm ai! Një gjë dihet: Ari mund të baltoset, por ai kudo që bie e ruan shkëlqimin e vet.

# MKRS-ja dhe UNDP-ja, të gatshme për bashkëpunim, në projekte të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore

**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur të enjten në një takim përfaqësuesen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP-së) në Kosovë, Maria Suokko, me të cilën ka biseduar për politikën dhe programin që MKRS-ja ka për rininë dhe çështjet që kanë të bëjnë me fushën e trashëgimisë kulturore.

Ministrja Dumoshi e ka njoftuar përfaqësuesen e UNDP-së, Suokko, për planet dhe synimet që pritet të realizohen nga ana e MKRS-së në këto fusha të cilat UNDP-ja ka interes të veçantë. Ministria është shprehur se do të angazhohet maksimalisht që


rinia e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë të takohen e shkëmbejnë idetë inovative që kanë për avancimin e interesave të tyre, sidomos në edukimin dhe integrimin sa më të madh social të tyre. MKRS-ja do të investojë në krijimin e mëtejme të hapësirave dhe infrastrukturës së nevojshme që të rinjtë në Kosovë të kenë ku t'u organizojnë dhe realizojnë aktivitetet e ngjarjet e tyre.

Gjithashtu, ministrja e ka informuar përfaqësuesen Suokko për planet që ka për fushën e trashëgimisë, për plotësimin dhe avancimin e legjislacionit që e rregullon këtë fushë. Ajo tha se MKRS-ja është e interesuar të bashkëpunojë me UNDP-në për

zhvillimin e projekteve të cilat mundësojnë mbrojtje më të madhe të monumenteve, objekteve dhe hapësirave të trashëgimisë kulturore.

Ministrja e ka falënderuar përfaqësuesen e UNDP-së për mbështetjen e deritashme që kanë dhënë për fushat që i mbulon MKRS-ja duke e mirëpritur gatishmërinë e UNDP-së që të bashkëpunojë edhe në të ardhmen për projektet në fushën e rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Ndërsa përfaqësuesja e UNDP-së, Maria Suokko, e uroi ministren për marrjen e detyrës dhe e falënderoi për gatishmërinë e ofruar për fuqizimin dhe përkrahjen e rinisë.



# ‘Isa Boletini’ furnizohet me energji elektrike nëpërmjet paneleve solare

**MITROVICË, 5 MARS (ER)** - Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof. dr. Alush Musaj dhe drejtori i Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Besart Hajrizi, kanë përfunduar të enjten projektin e sistemit solar fotovoltaik. Ky sistem solar, që është vendosur sipër objekteve universitare, ka kapacitetin prej 85.4kWp dhe është i përbërë prej 280 paneleve solare. Rektori Musaj ka thënë se me këtë projekt do të ulen ndjeshëm

shpenzimet e energjisë në UMIB. “Jemi shumë të kënaqur me realizimin e këtij projekti dhe do të provojmë që këtë ta zgjerojmë edhe më shumë në kuadër të kompleksit universitar”, ka deklaruar Musaj. Sipas tij, ky projekt e ka modernizuar edhe më shumë kompleksin universitar në Mitrovicë. Ndërsa drejtori i Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Besart Hajrizi, ka pohuar se ky projekt është

financuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) si rezultat i memorandumit të bashkëpunimit me UMIB-in. Sipas tij, përveç ndikimit praktik që ka instalimi i sistemit solar në kompleksin universitar të UMIB-së, ky sistem do të shërbejë edhe për qëllime studimore. Drejtori Hajrizi ka sqaruar se studentët dhe profesorët do të kenë qasje në hapësirat si dhe në projektin e sistemit solar fotovoltaik.



Kosova ka nisur shënimin e manifestimit të 22-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”

# ‘Epopeja e UÇK-së’ ndryshoi pol

Në 22-vjetorin e “Epopesë së UÇK-së” liderët institucionalë kanë thënë se rezistenca e Adem Jasharit dhe familjes së tij ndryshoi politikën dhe historinë e shqiptarëve të Kosovës. Ata kanë deklaruar se sakrifica e Jasharëve ka zgjuar ndërgjegjen shqiptare duke i mobilizuar ata. Në nderim të heroizmit të kësaj familje është mbajtur seancë solemne parlamentare, kurse në Kazermën “Adem Jashari” kanë parakaluar ushtarët e FSK-së e në kompleksin memorial në Prekaz janë bërë homazhe

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 MARS** - Institucionet më të larta shtetërore kanë nderuar heroizmin dhe sakrificën e komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe familjes së tij. Me



rastin e shënimit të 22-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, trupat e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Kazermën “Adem Jashari” kanë bërë parakalimin e tyre, ndërsa liderët institucionalë para të pranishëmve kanë vlerësuar se kjo epope ka ndryshuar historinë dhe politikën e shqiptarëve.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vetë emri i kësaj kazerme është emri i lirisë, i pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës. “Nderojmë anëtarët e familjes së Shaban Jasharit: burrat, gratë, vajzat, djemtë, fëmijët, nipërit, mbesat. Nderojmë komandantin legjendar Adem Jashari, Hamzën dhe gjithë të rënë të 5, 6 dhe 7 mars 1998 në Prekazin heroik”, ka thënë Thaçi.

Shefi i shtetit ka vlerësuar se heroizmi dhe sakrifica e Jasharëve zgjoi ndërgjegjen

shqiptare. “Heroizmi i Jasharëve mobilizoi botën shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës, në Mal të Zi, në Shqipëri dhe në diasporë. Heroizmi i Jasharëve dhe lufta e tyre titanike e vuri në lëvizje gjithë diplomacinë

energji për të ardhmen. “Kujtojmë me respektin më të lartë sakrificën e mijëra dëshmorëve, kujtojmë martirët dhe gjithë qytetarët tanë të rënë për liri. Kujtojmë plagët e invalidëve të luftës, kontributin e veteranëve dhe gjithë ushtarët e lirisë që ranë për liri dhe pavarësi të Kosovës”, ka theksuar presidenti.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, para ushtarëve të FSK-së ka thënë se Adem Jashari dha shembullin se si mbrohet toka e këtij vendi. “Sot ju jeni pjesëtarë të një force të armatosur, keni mision të shenjtë mbrojtjen e atdheut dhe sigurimin e tërësisë së tij territoriale. Ju i shërbeni atdheut çdo ditë dhe për këtë duhet të jeni krenarë. Por, po çdo ditë ju duhet ta ktheni kokën pas dhe ta kujtoni sakrificën e Adem Jasharit dhe të mijëra bijve e bijave të këtij vendi, të cilët e panë Kosovën të lirë dhe u përkushtuan për ta bërë atë shtet të denjë e të pacenueshëm. Në krahët tuaj ju e mbani stemën e Republikës, të

ndërkombëtare, botërore për Kosovën. Prandaj, bota shqiptare me respekt dhe nderim të lartë përkulet në Prekazin legjendar”, ka theksuar



presidenti Thaçi.

I pari i vendit ka thënë se sa herë që vijnë ditët e “Epopesë së UÇK-së” kujtojmë çmimin e lirisë së Kosovës dhe marrim

kësaj Republike e cila u krijua mbi sakrificën e shumë brezave. Prandaj, ju duhet të siguroheni se ajo do të jetë stema e vendit që e projektoi e për të cilin luftoi Adem Jashari”, ka thënë Osmani. Kurse kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se 22 vjet më parë po ndodhte kulmimi i një shtate të re, të ngjizur me vite e dekada të tëra, po ndodhte diçka e jashtëzakonshme të cilën bota nuk e kishte parë. “Po ndodhte që një familje e tërë, gra e burra, vajza e djem të familjes Jashari, me vetëdije e të patrembur, po luftonin me një shtet fashist të cilin bota ende nuk po e dëftonte si të tillë. Ishte kjo familje, ishte kryekomandanti dhe strategu i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem



Jashari, Hamzë Jashari e Baca Shaban, që njëherë e përgjithmonë, si askush tjetër, na treguan neve dhe botës, se kur liria është në pyetje, nuk ka as çmim e as forcë që mund t'i sprapsë apo ndalë nga qëllimi i tyre i gatuar me dashuri për atdheun e për njëri-tjetrin”, ka thënë Kurti.

Më tej, kryeministri Kurti ka theksuar se “Epopeja e UÇK-së” e ndryshoi politikën dhe historinë. “Jasharët e kishin vënë popullin mbi familjen dhe, kështu, e ndryshuan popullin

sepse e bashkuan atë dhe e ndryshuan secilën familje shqiptare sepse i vetëdijesuan ato. Gjithçka ndryshoi përgjithmonë”, ka thënë kryeministri Kurti.

Në emër të familjes Jashari, foli vëllai i komandantit legjendar Adem Jasharit, Rifat Jashari, i cili nga Kazerma “Adem Jashari” falënderoi të pranishmit dhe tha se vetë prania juaj në këtë manifestim nderon dhe përkujton veprën e Adem Jasharit dhe të gjithë dëshmorëve e të rënëve për liri.



# itikën dhe historinë e Kosovës



## Kuvendi mbajti seancë të veçantë

Intonimi i himnit shtetëror ka shënuar fillimin e seancës së veçantë të Kuvendit të Kosovës kushtuar 22-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të pranishmëve fillimisht u është drejtuar kryeministri Albin Kurti, i cili ka thënë se kjo datë është e shënuar për historinë e vendit tonë. “22 vjet më parë, më 5 mars, forca të shumta të policisë e ushtrisë serbe me



tanke e me artileri kishin rrethuar shtëpitë e Jasharëve në Prekaz. Po sulmoheshin sërish, sepse ishin sulmuar edhe në dhjetor 1991 e në janar 1998. Asnjë sulm nuk i zmbrapste e nuk i dobësonte, por vetëm i forconte. Për tri ditë rresht do të luftonin tre breza bashkë. Tre breza të një familje të madhe u flijuan për të ardhmen dhe për neve. Nga Shabani e Zahidja që ishin 74-vjeçar, te Igballja 11 vjeçe, Blerina 7 vjeçe e Kushtrimi 13 vjeç”, ka thënë Kurti.

Kurse kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka deklaruar se po e përkujtojnë veprën heroike të komandantit të UÇK-së, Adem Jasharit, sakrificën sublime të familjes Jashari për liri, si dhe ndikimin që kjo sakrificë e pati në përpjekjen tonë për liri. “Në fillim të viteve '90 Adem Jashari, si e gjithë Kosova, u përballë me një regjim të egër. Por, komandanti Adem Jashari ishte mësuar tashmë të jetonte nën kërcënimin e vazhdueshëm. Ishte mësuar të rrethohej, sikur i ngjau më 30 dhjetor 1991 e më 22 janar 1998. Kjo e kishte motivuar edhe më shumë për rezistencë, prandaj nuk i

## Veseli: Prekazi është referenca e çdo edukimi patriotik

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, në 22-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bërë homazhe në Kompleksin memorial të Jasharëve në Prekaz. Nëpërmjet postimit në llogarinë e vet në “Facebook”, Veseli ka thënë se Prekazi është referenca e çdo edukimi patriotik dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlera historike që i flet secilës gjeneratë. “Për nderime në Prekaz, në 22-vjetorin e Epopesë së UÇK-së. Flijimin për lirinë dhe të ardhmen e Kosovës më së qarti e tregon sakrificat e familjes Jashari. Prekazi është referenca jonë e çdo edukimi patriotik dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlera historike që i flet secilës gjeneratë. Lavdi e përgjeshme për të gjithë të rënë të lirisë!”, ka shkruar Veseli.

## Haradinaj: “Epopeja e UÇK-së” është e skalitur me emrat e heronjve

Edhe ish-kryeministri dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial të Jasharëve në Prekaz, ku ka theksuar se te Prekazi i Komandantit Legjendar Adem Jashari kujtojmë gjithnjë sakrificën më sublime për liri. Ai ka thënë se familja Jashari do të jetë përjetësisht e nderuar dhe frymëzimi më i madh i dashurisë për kombin. “Epopeja e UÇK-së është e skalitur me emrat e heronjve, dëshmorëve e martirëve tanë. Është kohë që kthen në kujtesën tonë kolektive emrat e atyre që flijuan jetën për liri, invalidëve të luftës, veteranëve dhe të pagjeturve në të gjitha trojet shqiptare! Lavdi të rënëve ndër breza dhe luftës së UÇK-së!”, ka thënë Haradinaj.

## Limaj: Më 5, 6 dhe 7 mars në Prekaz u ngritën themelet e shtetit tonë

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar “Epokën e UÇK-së” në 22-vjetorin e rënies heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe Jasharëve. Ai ka thënë se më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 në Prekaz janë ngritur themelet e shtetit të Kosovës. “Prekazi është vendi ku pavarësia dhe liria kanë marrë jetë dhe do të jetë në obligimin tonë gjithnjë për të qenë në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Ne me pietet kujtojmë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Flijimi për liri i familjes Jashari është shembulli më unik i cili na kujton që, ajo që sot e gëzojmë, është rezultat i sakrificës së kësaj familjeje”, ka thënë Limaj.

## Pacolli: Familja Jashari është sinonim i lirisë dhe TRIMËRISË

Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, me rastin e 22-vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, ka thënë se familja Jashari është sinonim i lirisë dhe trimërisë. “Është familja heroike e kombit tonë për të cilën do të krenohen gjeneratë pas gjenerate! Lavdi!”, ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në “Facebook”.

orën 17:00, në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, do të mbahet akademi përkujtimore kushtuar

komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe të rënëve për liri.



# Digjitalizimi, potencial për ekonominë e Kosovës

**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Rozeta Hajdari, ka marrë pjesë në lansimin e projektit ACCESS, i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC).

Ministrja Hajdari ka theksuar se digjitalizimi është potencial për ekonominë e Kosovës, që t'i shpërthejmë kufijtë rajonalë e ndërkombëtarë, posaçërisht ata drejt BE-së të vendosur padrejtësisht përmes regjimit të vizave. "Digjitalizimi nuk pyet për kufijtë fizikë, por e mundëson rrjedhën e lirë të ideve dhe projekteve bashkëpunuese. Digjitalizimi krijon mundësi për ndërmarrësit tanë dhe rininë e Kosovës, një pjesë e së cilës ende mbetet pa punë. Prandaj, jemi të përkushtuar që ta nxjerrim maksimumin nga ky zhvillim i kohës dhe jemi të përkushtuar që secili cent, qoftë i ardhur nga buxheti, qoftë nga financimet e partnerëve tanë, siç e kemi këtu rastin do të kthehet në dobi për shoqërinë. Ne duam t'i shfrytëzojmë projektet, si projekti ACCESS, për t'i përgatitur dhe ndihmuar

ndërmarrësit e rinj dhe ata ekzistues, konsulentët dhe të gjithë aktorët e tjerë në ekonomi, përfshirë institucionet publike. Qeveria e Kosovës i është mirënjohëse Qeverisë së Austrisë për ndihmën e pakursyer që jep në këtë drejtim, prandaj ne nuk do të kursejmë asgjë për ta mbështetur këtë projekt dhe nisma të ngjashme që do të vijnë në të ardhmen", ka thënë ministrja Hajdari. Ajo ka shtuar se qeveria është duke vepruar në rrethana mjaft sfiduese. Por, sipas saj, në njërën anë duhet ta kthejmë ekonominë e vendit në binarë, pas gati 20 vjetësh të keqmenaxhimit dhe praktikave korruptive.

Në këtë ngjarje u certifikuan 20 konsulentë digjitalë, që nga marsi i këtij viti do të fillojnë të ofrojnë shërbime të transformimit digjital. Certifikimi është paraprirë nga trajnimi i konsulentëve të cilin e ka mundësuar projekti "Qasja në treg dhe shërbimet e digjitalizimit për bizneset kosovare (ACCESS)".

Financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), ACCESS-i implementon një seri aktivitësh lehtësuese për ta mundësuar qasjen në treg të të



varfërve në Kosovë.

Arsim Aziri, nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim, ka theksuar se projekti ACCESS është vazhdim i përpjekjeve të ADC-së për forcimin e zhvillimit të sektorit privat në Kosovë dhe shënon një iniciativë të

rëndësishme drejt transformimit digjital të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve) në Kosovë. Përmes këtyre aktiviteteve, kompanitë vendore do të kenë një qasje më të lehtë në treg dhe një nivel të rritur të konkurrencës.

ACCESS po aplikon praktikat më të mira austriake për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit privat në Kosovë, duke i përshtatur ato me nevojat lokale për ta mbështetur digjitalizimin si shtytës për rritjen ekonomike.

## BQK-ja dhe Banka Botërore do ta vazhdojnë bashkëpunimin në funksion të zhvillimit ekonomik



**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, është takuar me drejtorin e Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut,

Marco Mantovanelli.

Temë diskutimi në këtë takim ka qenë Memorandumi Ekonomik i Vendit (Country Economic Memorandum) si dhe perspektiva dhe sfidat në të

ardhmen lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit. "Guvernatori Mehmeti shpalosi pikëpamjet e Bankës Qendrore lidhur me perspektivën e zhvillimit ekonomik në

përgjithësi dhe rolin e sektorit financiar si kontribuues kyç në financimin e ekonomisë, në veçanti. Gjithashtu, njoftoi ekipin e Bankës Botërore për performancën e mirë të sektorit

financiar në Kosovë dhe potencoi rëndësinë e këtij sektori në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit", ka njoftuar BQK-ja. Sipas këtij njoftimi, guvernatori Mehmeti ka falënderuar Bankën Botërore për ndihmën dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe ka shprehur gatishmërinë që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje.

Ndërsa drejtori i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, Marco Mantovanelli, ka thënë se institucioni që e drejton do të vazhdojë ta mbajë në nivel të lartë bashkëpunimin me BQK-në për realizimin e projekteve që për qëllim kryesor kanë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit financiar.

## Mbi 67 mijë persona vizituan hotelet e Kosovës në tremujorin e fundit të 2019-s

**PRISHTINË, 5 MARS (ER)** - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelevisë në Kosovë për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2019 (TM4). Sipas ASK-së, gjatë kësaj periudhe kohore hotelet e Kosovës janë vizituar nga 67 493 persona. Në tremujorin e katërt të vitit 2019, pjesë e anketës kanë qenë 216 hotele që ushtrojnë veprimtari

hoteliere në territorin e Kosovës. Pjesa më e madhe e hoteleve, sipas ASK-së, gjenden në rajonin e Prishtinës dhe Pejës. "Në TM4 2019, numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) ishte 67 493, prej tyre 38.83 për qind ishin vëndorë dhe 61.17 për qind ishin të jashtëm. Ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 114 209, prej tyre 35.01 për qind nga vëndorët dhe 64.99 për qind nga

të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve dhe netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Prishtinës me 30 834 vizitorë dhe 54 568 netqëndrimi. Numri më i madh i vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren, Pejë e kështu me radhë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, numri më i madh është nga Shqipëria, Gjermania, Turqia, etj", ka njoftuar ASK-ja.



# Sektori privat nuk po arrin ta ndjekë trendin e rritjes së pagave

PRISHTINË, 5 MARS - Hendeku mes pagës mesatare në sektorin publik dhe atij privat vazhdon të jetë i lartë. Derisa paga mesatare në sektorin publik arrin mbi 500 euro, në sektorin privat kjo pagë mesatare është nën 350 euro. Sektori privat ndër vite nuk ka arritur ta ndjekë trendin e rritjes së pagave siç ka ndodhur në sektorin publik. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2012, paga neto mesatare në sektorin publik ka qenë 384 euro ndërsa, sipas të dhënave të fundit, kjo pagë ka arritur mbi 500 euro. Në sektorin privat paga neto mesatare në vitin 2012 ka qenë 333 euro, kurse sipas të dhënave të fundit, kjo pagë nuk arrin më shumë se 350 euro. Përfaqësues të punëtorëve në sektorin privat kanë thënë se punëtorët në këtë sektor, ndonëse punojnë më shumë sesa punëtorët në sektorin publik, vazhdojnë të paguhen më pak.

Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat që funksionon në kuadër të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, në një bisedë për “Radion Evropa e Lirë” ka folur për një gjendje jo të mirë të të punësuarve në sektorin privat. “Gjendja e sektorit privat në Kosovë nuk është e duhur edhe në nivelin e pagave. Kjo ka ndodhur për shkak të mosveprimit institucional. Punëtorët e sektori privat kanë mbetur në ndërgjegjen e kompanive ku ata punojnë. Ka disa pronarë të kompanive private që respektojnë ligje, por ka disa të tjerë që nuk respektojnë asnjë ligj dhe punëtorët nuk trajtohen mirë”, ka thënë Azemi.

Ai ka shtuar se në sektorin privat paga minimale do të duhej të jetë 350 euro, aq sa është paga mesatare. “Është një kërkesë e jona që ua kemi bërë vite më parë të gjitha institucioneve të Kosovës që paga minimale në

sektorin privat të jetë 350 euro, por deri më tani nuk është arritur asgjë. Tani ne kemi biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe jemi pajtuar që paga minimale të jetë 350 euro”, ka thënë Azemi. Paga minimale në Kosovë, që nga viti 2011, nuk ka pasur ndryshime dhe vazhdon të jetë 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, këtë mospërputhshmëri mes të ardhurave në sektorin publik dhe atë privat e ka quajtur të papranueshëm. Ai ka thënë duhet ndihmuar biznesin vendës në mënyrën që të rritet punësimi dhe të rritet edhe paga mesatare në sektorin privat. “Është absurde që paga mesatare në sektorin publik është mbi 500 euro me një rrite mbi 100 euro në pesë vjetët e fundit, ndërkohë që kjo rritje nuk është as 15 euro në sektorin

privat ku ju e dini që pagat mesatare ngelen rreth 350 euro”, ka thënë Kurti.

Skënder Krasniqi nga Oda e Afarizmit të Kosovës ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se paga në sektorin privat do të duhej të ishte shumë më e lartë se në atë publik, por që në Kosovë është e kundërta. Sipas tij, pagat në sektorin privat do të mund të shënojnë rritje ndër vite, nëse krijohen politika të mira fiskale. “Arsyeja kryesore që pagat janë më të ulëta në sektorin privat është ambienti afarist jo i duhur në Kosovë. Ajo çka do të duhej të bëjë Qeveria e Kosovës në mënyrë që të rritet punësimi në Kosovë dhe bëhet ngritja e pagave është që të krijojë kushte dhe t'i heqë barrierat që e kanë vendosur biznesin në çdo hap të punës së tij”. “Tatimi të paguhet në inkasim dhe jo në faturim, të hiqet pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në doganë dhe të vendoset në brendi. Prodhimi

të ketë subvencionim, siç e ka çdo shtet. Në Kosovë më shumë favorizohen importuesit sesa prodhuesit, për këtë arsye edhe 90 për qind të produkteve importohen”, ka thënë Krasniqi. Numri i të punësuarve në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, është mbi 350 mijë. Nga ky numër në sektorin publik janë të punësuar rreth 85 mijë, kurse rreth 250 mijë qytetarë të tjerë llogaritet që punojnë në sektorin privat. Sipas një ankete të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, është thënë se të intervistuarit që punojnë në sektorin publik kanë raportuar orar më të shkurtër të punës se ata në sektorin privat. Derisa në sektorin publik, zbatohet orari pesë ditë punë dhe dy në fundjavë me gjithsejtë 40 orë punë, në sektorin privat është raportuar se të punësuarit punojnë me orar më të gjatë, krahasuar me të gjitha llojet e punësimit, deri rreth 47 orë në javë.



## Dogana rrit të hyrat për 11 për qind

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Dogana e Kosovës ka rritur të hyrat për buxhetin e Kosovës për 11 për qind më shumë se në periudhën paraprake. “Për herë të parë që nga themelimi


i Doganës janë grumbulluar rreth 170 milionë euro në fillim të muajit mars. Pra, kjo paraqet një të arritur të konsiderueshme. Krahasimi me vitin 2019 tregon se

qartazi se trendi i të hyrave është në rritje. Gjatë vitit të kaluar Dogana kishte mbledhur rreth 150 milionë euro, kurse këtë vit, po për të njëjtën periudhë, kemi arritur

të mbledhim rreth 170 milionë, që paraqet rritje prej 20 milionë eurosh më shumë apo 11 për qind më shumë”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



# Adem Jashari me familje e ndryshoi epokën historike



Akademik prof. dr. Hakif BAJRAMI

## ADEM JASHARIT-LEGJENDARIT

(Me krenari, 9 mars 1998)

*Ato ditë kur gjithësia për Ty lutej,  
Atë javë kur Zoti për Ty gjykoi,  
Shqiptaria të mos frikohej,  
Bota demokratike për kombin,  
Tënd ndryshe të mendojë.*

*Atë muej kur Zoti i gjithësisë,  
Për popullin tënd po lutej,  
Atë vit kur populli Yt u nda në dy,  
Një palë t'admironte e t'qante,  
Një palë të mallkonte e besa mëtej!  
E TY liria e kuçe e gjaku Yt i familjes sate,  
Të gjitha civilizimet i përshkoi nëpër dejë.*

*Atë ditë kur krenaria Jote u bë neoluftë,  
Ta lindë një familje një Epokë të re historike,  
Tërë bota për Ty dhe në Ty do të bëjë be,  
Sepse asnjë popull si i Bacë Adem Demës,  
Se nxënësit Tuej Adem Jashari s'kanë më u frikua,  
Pa bërë luftë për liri dhe për të shtrenjtin atdhe,  
Kështu është e kështu Epoka në gjithësi po del,  
Adem Jashari-Legjendari shembulli Yt për Liri,  
U bë për jetë e mot për tërë Botën model.*

## ADEM LEGJENDARIT

(Me admirim, më 9 mars 1999)

*Të dy sytë me bëjnë më tepër dritë,  
Edhe pse jam lodhë e vrugnua,  
Nga padrejtësitë e robërisë e pas,  
Por kur emrin Tënd e ndiej,  
Kurrë më krenar nuk bëhem,  
Kur e shoh pamjen e Juej,  
Djersëm e zverdhem mos jam i huaj,  
Se kam dëshirë të jam me ty për TY,  
Në bylykun e Kombit tuaj.*

*E Zemra më mbushet diell,  
Kur e di se jam i kombit tënd.  
Truri më fol Hënë e plotë,  
Se në errësirën e robërisë,  
Si amanet që e bëre,  
Kurrë kombin në robëri ma  
S'kemi me ta lënë!*

*Ndalem e krenohem i lëshoi dy pika lot,  
Bacë! Ti edhe sot komandon.  
Bacë me gjakun tënd një komb,  
E ke përtërirë mos e harroni,  
Nuk jam ai që të përkujtojë  
Vetëm në çdo jubile,  
Por jam ai që kam ëndërruar kësi heroi,  
Prej ditës kur kam folur,  
Pse jo edhe prej çastit kur kam le.*

## NGA SHKOLLA KOMBËTARE E PREKAZIT DERI NË ÇLIRIM

Për ta gjetur rrugën e re, për ta çliruar kombin, Adem Jashari me shokë e panë të nevojshme se duhej lexuar shumë, se duhej mësuar në çdo çast. Ky fakt do të mësohet gjatë qëndrimit për ushtrime ushtarake në Akademinë “Skenderbej”, në Tiranë. Kuptohet, mësuan te profesorët patriotë dhe shkencëtarë të akademisë prestigjioze. Pikërisht për këtë, gjeneratës së Adem Jasharit i duheshin njohuri të plota mbi luftën guerile, e cila nga mësimet në Akademinë “Skenderbej” në Tiranë u kthye në luftë speciale.

Në lidhje me këtë, luftën speciale, komandanti legjendar Adem Jashari filloi ta avancojë duke u mbështetur jo vetëm nga leksionet speciale, jo vetëm në literaturën profesionale ushtarake, por edhe në traditën e ndritur të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), Lidhjes Shqiptare të Pejës (1899), në trimërinë e Ahmet Delisë, Hasan Prishtinës, Kamer Loshit, Azem Bejtës, Ramë Vllasës, Osman Pollatës, Dan Dorocit, Shaqir Igrishtës, Ilaz Raçalkut, Bajram Currit, Nazim Gafurrit, Luftës antifashiste të Emin Durakut, luftës antifashiste dhe antiçetnike të Shaban Polluzhës, në luftën politike të NDSH-së së Halim Spahisë, LRBSH-së së Adem Demaçit e deri te Ruzhdi Xhakja me shokë në Besi (2 prill 1981), e Tahir Meha me familje në Prekaz (13 maj 1981).

Adem Jashari, duke e begatuar traditën e luftës për liri, e lidhi politikën e Adem Demaçit dhe NDSH-ja në rrafshin horizontal dhe vertikal, duke e bërë luftën e drejtë tredimensionale: lartësia, gjerësia dhe gjatësia e saj, e begatuar me moral të pashterur, se nuk i vërsulet askujt që nuk është violentë ndaj atyre që luftojnë për liri, pasi që ishte proklamuar se atdheu - Kosova nuk duron më robëri.

Adem Jasharit, komandantit të një ushtrie në themelim, i interesoi deri në përkushtim politika e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Mësoi për luftën e drejtë dhe rolin e demonstrimit popullor, me theks të posaçëm për demonstratat shqiptare në Kosovë dhe viset tjera të robëruara më 1968. Adem Jashari mësoi se demonstratat e viteve 1981-1989 e kishin një mision civilizues, sepse e nxirrnin popullin nga letargjia dhe politika e diferencimeve dhe e forconin bindjen se çlirimi i Kosovës kërkon sakrifica sublime, duke shtuar se ideologjia nuk mundet të kryej punë aty ku kërkohet të flet gryka e pushkës së orës të Ali Ajetit me shokë.

Adem Jashari në Akademinë “Skenderbej” dhe nga rrethi shoqëror me të cilin jetonte në Shqipëri, sidomos, mësoi se okupatori serbian po i ushtron dy politika robërie ndaj shqiptarëve: me një anë po vret ushtarë shqiptar nëpër kazemat e tyre (1981-1990), në anën tjetër po vret demonstrues civilë në kontinuitet. Lidhur me këtë, vrasja e Jusuf Gërvallës me shokë, vrasja e Enver Hadrit, vrasjet e të rinjve dhe të rejave në vijim në Kosovë, janë një alarm se kombi duhet të zgjohet. Dhe kur të ngritët “opinga dhe hosteni, të huajit nuk do t'i mbetet ma vendi”, me Adem Jasharin-legjendarin në ballë.

Adem Jashari afroi rreth veti një forcë të organizuar djalërie të cilët ishin të dëlirë, sepse prindërit e tyre kishin një shkollë që lirisht mund të quhet se kishte për “kryeqytet” Prekazin. Së këndejmi, lufta e Tahir Mehës për Adem Jasharin dhe ushtarët e tij, ishin pjekë dhe përgatit për një luftë të programuar dhe të komanduar, gjithnjë të drejtë, në çdo aspekt. Së këndejmi, Adem Jashari ishte i udhëzuar se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që do ta komandojë, nuk guxon të jetë kundër civilëve të cilit do komb, që jetojnë me bindje se të gjithë qytetarët duhet të janë të barabartë. Adem Jashari nuk ka bërë luftë selektive, çdo dhunues të lirisë, qoftë ai sllav apo shqiptar, duhet ta ndiej peshën e luftës prej së cilës kishte krijuar bindje se shteti dhe politika koloniale e atij shteti okupator, do të dalë humbës i dyfishtë. Dhe, doli.

Adem Jashari kishte mësuar në Akademinë “Skenderbej” në Tiranë, se ngritja në kryengritje do përkrahje gjithëkombëtare, do përgatitje teorike dhe praktike, do armatim dhe logjistikë që nuk është në

funksion vetëm për një ditë e tri ditë siç ka ngjarë në historinë tonë. Por lufta e Adem Jasharit, lufta e UÇK-së e komanduar nga një institucion ishte e përgatitur që të bëjë sakrifica për një kohë shumë të gjatë. E kur të sigurohet ky qëndrim në masë absolute, paralelisht me këtë, duhet jo vetëm përkrahja verbale, por edhe materiale e miqve që do të sigurohen me luftën tonë politike dhe civilizuese, duke shpjeguar të drejtën shqiptare, si e drejtë imediate dhe e domosdoshme deri në pashmangshmëri.

Historia e UÇK-së gjatë viteve 1992-1999, gjithnjë e më shumë po merrte përmasa të gjëra në lëminë e hulumtimit të shkencave të Historisë, Filozofisë, Politologjisë, Sociologjisë, Diplomacisë, Gjeostrategjikë, Etnopsikologjisë dhe të organizimit në përgjithësi, kudo në glob. E tërë kjo, për faktin se u themelua një ushtri që nuk kishte kazerma ushtarke, nuk kishte banka, nuk kishte fabrika armatimi, nuk kishte shtete të fuqishme që e përkrahnin luftën e saj të drejtë, në fillim.

Historikisht pra, UÇK-ja e ka ndarë mendimin për luftën, sepse kjo ushtri e Adem Jasharit, u krijua në kushte speciale për të bërë luftë speciale. E lufta e saj e drejtë do të quhet substancialisht neoluftë, për dallim nga paleolufta.

Në paleoluftë çdo gjë zhvillohet me qëllim kriminal. Paleolufta ishte mizori, që vrasjet në mes palëve ndërluftuese të jenë sa më të mëdha, por që fundi të sjellë jo vetëm fitore ushtarke, por edhe politike, duke krijuar njëfarë miti religjioz, duke i thurë kryeheroit “veprime” imagjinare.

Në neoluftën e Adem Jasharit qëllimi është (i palës që bën luftë të drejtë) që vrasjet të jenë sa më të pakta në numër, në mënyrë që fundi i saj të merret me çështje të viktimave, me çështje të humanizmit të kundërtënieve. E vërteta, për herë të parë (ata që bëjnë luftë të drejtë) në histori, fitimtarët nuk janë më



uzurpues të industrisë së kotë siç janë reklammat për ndonjë luftë të re. Por çdo popull i robëruar me neoluftë, vihet në shans dhe në shembull se drejtësia demokratike e jo-totalitarizmi, qoftë i majtë, apo i djathtë, pra të dy ekstremet, t'i fryjnë xhepat e tregtarëve të armëve dhe të sigurojnë para. Neolufta, është pra një filozofi që mund t'i faturohet ushtrisë së Adem Demaçit dhe Adem Jasharit, si parathënie e zbritjes së njeriut nga "ajri në tokë", për t'u këndellë truri i çdokujt, se edhe tjetri që nuk është si ti, ka të drejtë në jetë, ka të drejtë në çlirim kombëtar dhe ekonomik. Me fjalë tjera, Ushtria Çlirimtare e Adem Jasharit i ka humanizuar vlerat e luftës, sepse nuk vret e nuk dhunon: civilë, gra, fëmijë, pleq, plaka, njerëz pa armë në dorë. Me fjalë tjera Adem Jashari nuk i kishte rrokë armët me shokë shumë, për ndonjë aventurë. Aventurën e Beogradit UÇK-ja ia faturon okupatorit që nuk po dallonte mjete, duke vrarë e dhunuar civilë (duke synuar spastrim total që shënoi në kulmin e luftës edhe gjenocidin, sepse nga Kosova u detyruan të shpërngulën 985 655 civilë duke u shpërndarë të katër anët e botës. Pra gjenocidi nuk mund t'u përshkruhet rreth 14 000 të vrarëve, por gjenocidi konceptualisht vërtetohet me 1 500 000 shqiptarë të zhvendosur civilë, nga shtëpitë e tyre. E vërteta, Adem Jashari dhe familja e tij famëlartë, kishin pësuar më shumë sepse ishin vrarë e masakruar, gati të gjithë. Edhe më saktë, okupatori për të humbur gjurmë kishte filluar të bartë kufoma nëpër Serbi, për t'i varrosur aty dhe andej kah nuk do të dihej ma kurrë (mars-prill 1999).

Lufta e Adem Jasharit, në anën tjetër kishte adresë, kishte mision e jo fikcion që të vrasë këndo që i del përpara. Mu për këtë, okupatori dhe agjenturat e tij, në bazë të dokumenteve u përkujdes që t'i vrasë disa figura të njohura shqiptare, krejt me qellim që të mbetën enigma, pale mos do të fillohet lufta qytetare ndërshqiptare, e cila do të ishte shumë më e egër se lufta klasike-paleolufta. Lufta e UÇK-së së Adem Jasharit e ka edhe një çështje dalluese nga ajo që bëri okupatori. Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Adem Jasharit nuk rrënon ura, nuk djeg shtëpi, nuk djeg arkiva e biblioteka, nuk rrënon objekte të kultit, nuk lëshon qoftë edhe një plumb mbi objektet që e përfaqësojnë okupatorin, sepse e kishte në ndërgjegje se shqiptarët dhe serbët janë fqinjë. Pra, shqiptarët si autokton mendojnë të jetojnë në trojet e veta, pra nuk rrënojnë asgjë, por okupatori që e ka të qartë misionin dhe fiksin, provon që mos të mbetet asgjë pa u dëmtuar, duke proklamuar edhe stilin e luftës për: "tokën e djegur dhe pa shqiptarë".

E kush e ktheu jetën në "tokën e djegur dhe pa shqiptarë", shtrohet pyetja sot, vetëm lufta e drejtë e UÇK-ës. Dhe, kur t' i shtohet kësaj lufte edhe fuqia ushtarake e NATO-s që u rreshtua në anën e Adem Jasharit dhe ushtrisë tij, atëherë fitorja e saj është e dëlirë si hëna e plotë, si dielli që shndritë gjithësinë.

Në fund, shumë është folur për karakterin e atyre që e lëshuan Kosovën (nga presidenti me familje e deri të qytetari i rëndomtë më 1999) dhe atyre që sakrifikuan dhe mbetën, qoftë në varre qoftë duke i ndërruar vendstrehimet, por kurrë nuk e lëshuan Kosovën me UÇK-në në ballë, duke vlerësuar se kemi të bëjmë me një dallim cilësorë të veprimit. E veprimi i Adem Jasharit dhe familjes së tij që qëndroi dhe u sakrifikua në shtëpi, u bë shembull i luftës që nuk mund të përshkruhet tani për tani vetëm me fjalë, sepse pavarësia e Republikës Kosovës, vlen më tepër si në kohë ashtu edhe në kuptimin tredimensional: lartësi morale, gjerësi jetësore dhe largësi kohore, sepse koha nuk vdes kurrë, mësa Adem Jashari me familje, as për neve e as për civilizimin, sepse mbetet katakomb edukimi për njeriun aktiv dhe liridashës-lirindërttonjës.

Lufta e Adem Jasharit me familje ishte një neoreferendum që njeriu t'i besojë vetes, t'i besojë bukës së vet, zakoneve të veta, armëve të veta, fuqisë popullore mbrojtëse, fuqisë civilizuese që janë në dobi të kohës, sepse misioni dhe vizioni i lirisë nuk vdesin kurrë. Pra, Adem Demaçi, Adem Jashari dhe UÇK-ja janë një projekt civilizues tredimensional, si teorema e Pitagorës, që do të rrezatojnë si dielli gjatë historisë. T'ia japim besën shqiptarë këtij projekti, se do të kujtojmë këtë vepër, se nuk do ta lëshojmë kurrë nga zemra dhe mendja derisa të ketë jetë mbi tokë. Respekt dhe përkulje para dëshmorëve të kombit dhe veprës sublime të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të neoluftës, që i priu krenarisht emri dhe vepra e Adem Jasharit - Legjendarit.

## MKRS-ja dhe Komuna e Prishtinës me shumë projekte të përbashkëta në dobi të kryeqytetasve

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Vlora Dumoshi, ka vizituar të enjten Komunën e Prishtinës, ku është takuar me kryetarin Shpend Ahmeti, me të cilin kanë diskutuar për projektet e përbashkëta të MKRS-së dhe të komunës, për investime kapitale dhe aktivitete konkrete - ngjarje kulturore, rinore dhe sportive. Në këtë takim ministria Dumoshi ka thënë se bashkë me kryetarin Ahmeti kanë folur për bashkërendimin e veprimeve që të konkretizohen e finalizohen projektet kapitale që do të realizohen në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, si Teatri i Operës dhe Baletit, Muzeu Bashkëkohor, projektet në stadiumin e qytetit, qendra e tenisit e



shumë projekte të tjera që janë në interes dhe në dobi të qytetarëve. "Biseduam me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, për ndërlidhjen dhe bashkëveprimin në projekte të ndryshme. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në buxhetin e vet ka edhe projekte kapitale të cilat i takojnë dhe do të vendosen në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Biseduam edhe për Teatrin e Operës dhe Baletit dhe për

projekte të tjera" ka thënë Dumoshi. Ndërsa kryetari Ahmeti ka thënë se ky takim i parë me ministren Dumoshi nuk do të jetë i vetmi ngaqë për tema të përbashkëta do të ketë edhe takime të tjera për konkretizimin e tyre. Kryetari Ahmeti ka thënë se ministria Dumoshi e njeh për së afërmi situatën dhe nevojat që ka kryeqyteti për përkrahje, pasi ka qenë drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në komunën tonë. Në takim është diskutuar edhe për ngjarjet kulturore e sportive që janë në plan të organizohen sivjet në kryeqytet dhe u shikua mundësia e përkrahjes dhe pjesëmarrjes së përbashkët në këto ngjarje, të cilat e pasurojnë jetën kulturore dhe sportive.

## Përurohet projekti për krijimin e ambientit në Gorozhup si destinacion turistik

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Vlora Dumoshi, ka vizituar të enjten Komunën e Prishtinës, ku është takuar me kryetarin Shpend Ahmeti, me të cilin kanë diskutuar për projektet e përbashkëta të MKRS-së dhe të komunës, për investime kapitale dhe aktivitete konkrete - ngjarje kulturore, rinore dhe sportive. Në këtë takim ministria Dumoshi ka thënë se bashkë me kryetarin Ahmeti kanë folur për bashkërendimin e veprimeve që të konkretizohen e finalizohen projektet kapitale që do të realizohen në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, si Teatri i Operës dhe Baletit, Muzeu Bashkëkohor, projektet në stadiumin e qytetit, qendra e tenisit e



shumë projekte të tjera që janë në interes dhe në dobi të qytetarëve. "Biseduam me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, për ndërlidhjen dhe bashkëveprimin në projekte të ndryshme. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në buxhetin e vet ka edhe projekte kapitale të cilat i takojnë dhe do të vendosen në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Biseduam edhe për Teatrin e Operës dhe Baletit dhe për

projekte të tjera" ka thënë Dumoshi. Ndërsa kryetari Ahmeti ka thënë se ky takim i parë me ministren Dumoshi nuk do të jetë i vetmi ngaqë për tema të përbashkëta do të ketë edhe takime të tjera për konkretizimin e tyre. Kryetari Ahmeti ka thënë se ministria Dumoshi e njeh për së afërmi situatën dhe nevojat që ka kryeqyteti për përkrahje, pasi ka qenë drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në komunën tonë. Në takim është diskutuar edhe për ngjarjet kulturore e sportive që janë në plan të organizohen sivjet në kryeqytet dhe u shikua mundësia e përkrahjes dhe pjesëmarrjes së përbashkët në këto ngjarje, të cilat e pasurojnë jetën kulturore dhe sportive.

## Komuna e Gjilanit nderon profesorin dhe humanistin Naim Shaqiri

GJILAN, 5 MARS (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është organizuar të enjten një mbledhje përkujtimore me rastin e ndarjes nga jeta të profesorit Naim Shaqiri, të cilin e kanë vlerësuar të gjithë të pranishmit për kontributin e dhënë që nga aksioni për pajtimin e gjaqeve e deri në ditët e sotme në përkushtimin për punë dhe përgatitjen e nxënësve për të ardhmen. Në fjalën e tij, kryetari Haziri ka thënë se Gjilani është në ditë zie për ndarjen nga jeta të profesor Naim Shaqirit, në shenjë respekti për veprën e madhe



dhe aktivitetin permanent që ai ka bërë gjatë gjithë jetës. "Jemi sot këtu, në këtë objekt të bibliotekës së qytetit, sepse ai e dëshoi këtë vend, u përkujdes për këtë projekt dhe sot bashkërisht jemi në nderim të jetës dhe

veprës së Naim Shaqirit. Të nderuar veteranë të arsimit, rotarianë, nxënës të tij kudo që jeni dhe të pranishëm, Naimi ka qenë me të gjithë ne. Me Naimin jam njohur që nga protesta e 1 tetorit të para 32 vjetëve, si gjilanas dhe i pjekur sepse ai ishte edukator për ne dhe rezistues në proces. Pos kësaj ai ishte edhe pajtimtari i parë i anës sonë në Këshillin e Kosovës për Pajtimin e Gjaqeve që, në fakt, ishte pajtim kombëtar apo politik i të gjithë shqiptarëve në atë kohë", ka thënë ai. Haziri ka thënë se ai ishte aktiv dhe i pandalshëm deri në ditën e djeshme.

## Mbahet panairi i inovacionit në Viti

VITI, 5 MARS (ER) - Organizuar nga nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Jonuz Zejnullahu" në Viti, të enjten në ambientet e kësaj shkolle është mbajtur panairi i inovacionit. Me këtë rast, nxënësit e kësaj shkolle profesionale kanë paraqitur punimet e tyre. Të pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe kryetari i Komunës së Vitit, Sokol Haliti dhe drejtori i Arsimit, Basri Aliu, me



bashkëpunëtorë të tjerë. Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari Haliti ka përgëzuar nxënësit për

punimet e tyre dhe është zotuar se Komuna e Vitit në bashkëpunim me partnerët e tyre do të kujdesen vazhdimisht që kjo shkollë të marrë trajtimin e duhur e të jenë të përgatitur për tregun e punës. Ai ka potencuar se në këtë shkollë janë realizuar projekte të shumta dhe ka shtuar se ata do të vazhdojnë të punojnë që mësimdhënia dhe mësimnxënia në këtë shkollë të jenë sa më e lartë.

## Turqi-Rusi pajtohen për krijimin e një korridori të sigurt në Idlib

**MOSKË, 5 MARS** - Turqia dhe Rusia ranë dakord të krijojnë një korridor të sigurt përgjatë një autostrade kryesore që ndodhet në Idlib të Sirisë si dhe për kryerjen e patrullimeve të përbashkët aty duke filluar nga 15 marsi.

Kjo thuhet në një deklaratë të përbashkët pas bisedimeve të zhvilluara në Moskë të enjten me synim lehtësimin e tensioneve në këtë rajon. Në

deklaratën e firmosur nga ministrat e jashtëm, të të dy vendeve thuhet se korridori i sigurt do të shtrihet në një gjatësi prej 6 kilometrash në veri dhe 6 në jug të autostradës “M4”.

Aty thuhej se ministrat e mbrojtjes të të dy vende do të bien dakord mbi parametrat e këtij korridori brenda shtatë ditësh. Në deklaratë thuhej se patrullimet e përbashkëta do

të nisin përgjatë autostradës nga vendbanimet në Trumba në perëndim të qytetit strategjik të Saraqeb-it në drejtim të vendbanimeve Ain al Havr.

Ky zhvillim u parapri nga takimi mes presidentit rus Vladimir Putin me homologun turk Tayip Erdogan në një përpjekje për të arritur një armëpushim të mundshëm në veri të Sirisë. Më herët

gjatë ditës presidenti rus tha se situata në provincën Idlib, ku ushtritë e dy vendeve po ballafaqohen me një luftë që ka shpërngulur rreth një milion njerëz në tre muaj, ishte tensionuar aq shumë sa kërkonte bisedime kokë më kokë.

Kombet e Bashkuara thonë se në Siri është shkaktuar kriza më e rëndë humanitare gjatë 9 viteve luftë, e cila ka detyru-



ar miliona njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre si dhe ka shkaktuar vrasjen e qindra mijëra të tjerëve.

## Fitorja e Bidenit riformaton garën e demokratëve

Kthimi dramatik politik i ish-nënpresidentit Joe Biden, që pak veta mund ta kishin parashikuar vetëm disa ditë më parë, ka riformatuar betejën kryesore demokrate në një garë mes tij dhe senatorit të Vermontit, Bernie Sanders



**UASHINGTON, 5 MARS** - Ish-kryetari i bashkisë dhe miliarderi i Nju Jorkut, Michael Bloomberg, dështoi në garën presidenciale të mërkurën, një ditë pasi ish-nënpresidenti Joe Biden shënoi fitoret kryesore në disa nga zgjedhjet paraprake të Super të Martës. Kthimi dramatik politik i Bidenit ka riformatuar betejën kryesore demokrate në një garë mes tij dhe senatorit të Vermontit, Bernie Sanders, ka njoftuar “voa”.

Për demokratin Joe Biden, fitoret e Super të Martës në një mori shtetesh shënuan një rikthim politik që pak mund ta kishin parashikuar vetëm disa ditë më parë. “Ne duam një kandidat i cili do të mposhtë Donald Trumpin, por edhe që do ta mbajë Nancy Pelosin kryetare të Dhomës së Përfaqësuesve dhe që demokratët të fitojnë përsëri

Senatin! Nëse kjo është ajo që dëshironi, bashkohuni me ne!”, tha ai.

Bideni fitoi në disa shtete jugore falë mbështetjes së fuqishme të votuesve afrikano-amerikanë.

Ish-nënpresidenti tani ka riformatuar në mënyrë dramatike garën e demokratëve si një përballje mes dy burrash - ai dhe senatori Bernie Sanders. Sandersi fitoi në shtetin me numrin më të madh të Super të Martës, Kaliforni dhe tani po e portretizon veten si njeriu në disavantazh që lufton me bazën konservatore të Partisë Demokrate. “Në historinë e kohëve të fundit nuk ka pasur asnjëherë një fushatë që ka marrë përsipër të përballlet me bazën e partisë dhe ky është një institucion që po punon furishëm për të na munduar”, tha senatori Sanders.

Bideni tani përfiton nga mbështetja e ish-kryetarit të bashkisë së Nju Jorkut dhe miliarderit Michael Bloomberg. Bloomberg u largua nga gara të mërkurën pasi harxhoi gjysmë miliard dollar në reklama televizive, por u zotua të ndihmojë për të mposhtur presidentin Trump. “Fitorja në nëntor. Jo fitore për mua apo fushatën tonë, por fitore për vendin tonë”, tha ai.

Fati politik i Bidenit mori një kthesë dramatike pas fitores së tij javën e kaluar në Karolinën e Jugut. “Joe Biden fitoi në vende si

Virginia, ku nuk kishte ndonjë infrastrukturë. Dua të them nuk kishte as një zyrë, nuk kishte harxhuar asnjë para dhe aty pamë pjesëmarrje rekord për Joe Biden. Pra, pamë një ndryshim të mrekullueshëm sizmik në preferencën e votuesve në një kohë shumë të shkurtër”, tha strategjistja demokrate Penny Lee.

Një arsye e madhe për ngritjen e Bidenit ishin votuesit demokrate që morën një vendim të rëndësishëm, thotë ekspertja Lara Brown. “Pjesa më e madhe e mbështetjes së nënpresidentit

Biden nuk ishte thjesht votë për Bidenin, aq sa ishte një votë kundër Sandersit”, tha ajo.

Zgjedhjet e Super të Martës treguan se shumica e votuesve demokrate kanë një përparësi thelbësore, thotë Larry Sabato. “E vetmja gjë që demokratët duan më shumë se gjithçka, dhe shumë më tepër se zakonisht, është të mposhtin presidentin në detyrë. Mospëlqimi i fortë i Donald Trump është i dukshëm”, tha Sabato.

Sanders iu afrua shumë Hillary Clintonit katër vjet më parë, por mund të ketë një sfidë më të vështirë këtë herë përballë Bidenit, thotë analisti David Barker. “Një pjesë e konsiderueshme e mbështetjes së Sandersit në vitin 2016 ishte më shumë kundër Hillary sesa ishte pro Sandersit. Dhe frika dhe zemërimi ndaj presidentit aktual është shumë, shumë më e madhe sesa ishte për ish-presidentin. Dhe kjo pjesë po nxit rikthimin e Bidenit dhe kjo do të vazhdojë”, tha Barker.

Biden dhe Sanders përballen javën e ardhshme në zgjedhjet paraprake në Miçigan, Misisipi, Mizuri dhe Uashington.

## Talibanët po respektojnë pjesën më të madhe të marrëveshjes



**UASHINGTON, 5 MARS** - Shefat e mbrojtjes amerikane u thanë ligjvënësve se rezultatet fillestare nga Marrëveshja e Paqes me talibanët kanë qenë të përziera, por ata këmbëngulin që grupi ekstremist po respekton pjesën më të madhe të marrëveshjes, pavarësisht ringjalljes së dhunës vdekjeprurëse në Afganistan. Sekretari i mbrojtjes, Mark Esper, i tha një paneli të Senatit të mërkurën se ekstremistët po

respektojnë marrëveshjen, duke mos sulmuar forcat e ShBA-së dhe koalicionit, por jo në aspektin e uljes së dhunës.

Esper, i cili u takua në Kabul me krerët afganë ndërsa Marrëveshja e Paqes ishte nënshkruar në Katar, i tha panelit të Senatit se marrëveshja lejon ushtrinë e ShBA-së të veprojë për t'i mbrojtur forcat afgane.

Komentet erdhën pasi Pentagoni tha se forcat amerikane kishin

kryer një sulm ajror “mbrojtës” kundër luftëtarëve talibanë në provincën jugore të Helmandit në Afganistan, pasi ishte sulmuar një pikë kontrolli e drejtuar nga forcat afgane.

Militantët talibanë vranë të paktën 20 oficerë afganë të sigurimit në një varg sulmesh, pavarësisht bisedës telefonike “shumë të mirë” të presidentit amerikan, Donald Trump, me shefin politik të talibaneve.

## Vdes ish-shefi i OKB-së, Javier Perez de Cuellar

**Peru, 5 mars** - Ish-shefi i Kombeve të Bashkuara, Javier Perez de Cuellar, i cili ndihmoi ndërmjetësimin e armëpushimit në luftën Iran-Irak, ka vdekur në Peru, në moshën 100 vjeç, tha djali i tij më 5 mars.

Perez de Cuellar shërbeu si

sekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nga 1981 deri më 1991. Ai udhëhoqi OKB-në gjatë periudhës kur ndodhi lufta tetëvjeçare midis Iranit dhe Irakut, si dhe lufta civile në El Salvador.

Ai ishte president i Këshillit të

Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nga 1973 deri më 1974 dhe ishte përfaqësues i përhershëm i OKB-së në Qipro nga 1975 deri në 1977. Shefi aktual i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, më 19 janar, kur Javier de Cuellar shënonte ditëlindjes e

100-të, shkroi në rrjetin social “Twitter” për kontributin dhe arritjet e tij. “Ne në Kombet e Bashkuara udhëhiqemi me shembullin e tij dhe jemi shumë mirënjohës për kontributet dhe arritjet e tij të shumta si sekretar i përgjithshëm”, tha Guterres.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



*Shijo  
Pranverën  
me...*



E rrallë

## Hoteli me 7 yje, i vetmi në botë

Hoteli i vetëm në botë me 7 yje është në Dubai. Ai është i vendosur brenda një kulle 321 metra. Është një çudi arkitekturore që e bën një nga destinacionet më të mira turistike në botë. Në hotel janë 202 suita luksoze dhe ofrohen shumë shërbime të tjera. Turistët, gjithashtu, kanë mundësinë e rregullimit të vëllimit të dritës dhe muzikës përmes një telekomande.



FOTO E DITES



Fotografi e realizuar pas stuhisë që ndodhi në Nashville të Tenesit. /AP/

E jashtëzakonshme

## Kanibalizëm në Arktik, arinjtë polarë po hanë njëri-tjetrin

Rastet e arinjve polarë që vrasin dhe hanë njëri-tjetrin janë në rritje në Arktik pasi shkrirja e akullit dhe veprimtaria njerëzore gërryen habitatin e tyre, thonë shkencëtarët rusë. Ndryshimet klimatike dhe shfrytëzimi i karburanteve fosile në zonë përmenden si arsye. Shkrirja e akullit të shkaktuar nga ngro-

hja globale, por edhe nga shtimi i numrit të kompanive në Arktik, privon arinjtë polarë nga mundësia për gjueti, kështu që ata detyrohen të kthehen në kanibalizëm duke sulmuar këlyshët e tyre.



## BARSOLETA E DITËS



- Flasin dy fqinje dhe njëra e pyet tjetrën:
- Kush ishte ai që doli dje nga banesa jote?
  - Është një profesor universiteti.
  - Është i rregullt?
  - Jo, vetëm kur e kam burrin në udhëtim.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.


**Regjia:** Jake Kasdan



### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams



### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.



**DASHI**  
Përkushtohuni ndaj një projekti që

dëshironi të realizoni me gjithë forcën tuaj. Është koha për t'i arritur qëllimet tuaja.



**DEMI**  
Energjia dhe pasioni janë

ndërthurur pozitivisht me shpresën për ta goditur objektivin tuaj dhe, mbase, edhe të fitoni një çmim.



**BINJAKËT**  
Tani keni mjaft kohë për t'u

çlodhur, për të rimenduar dhe për të lexuar një libër të mirë. Merreni shtruar, do të krijohet një mundësi për të hequr një pengesë.



**GAFORRJA**  
Ju mund të filloni nisma të reja, me

sigurinë se me kalimin e kohës ata do të japin fryte. Një projekt vërtetoi se keni një mik të vërtetë dhe do të merrni shumë kënaqësi në fund.



**LUANI**  
Do të keni një ndjenjë intoler-

ance që së pari nuk mund të arrini ta kapni. Mundohuni të pajtoheni me pasqyrën, nëse nuk ju pëlqen imazhi që do të shihni dhe bëhuni më pak intrigant me veten.



**VIRGJËRËSHA**  
Intuita juaj do të

dëshmojë të jetë e saktë. Në fushën sentimentale, më në fund, do ta rregulloni një marrëdhënie ku ditët e fundit, ka shkaktuar shqetësime dhe disa momente pasigurie.



**PESHORJA**  
Plot pritje! Marrëdhënia në çift mund

të ketë disa konflikte, por dialogu dhe komunikimi, jo vetëm verbal, do të ketë shumë efekt pozitiv.



**AKREPI**  
Të gjithë ata rreth jush

shfaqen si armiq! Kushtojini vëmendje mirëqenies suaj duke zgjedhur atë që ju siguron kënaqësi dhe relaksim.



**SHIGJETARI**  
Nuk ka asnjë lajm të madh, por

një rutinë e heshtur dhe një zell i mirë që dëshmon produktiv në një nivel praktik.



**BRICJAPI**  
Asnjë re në qiellin tuaj nga pikëpamja

sentimentale: partneri juaj do t'ju ndjekë në të gjitha aspektet. Përmirësoni aftësinë tuaj fizike dhe estetike.



**UJORI**  
Në punët e caktuara për këtë ditë do të

tregoheni intuitiv dhe të mençur, do të arrini suksese dhe do të ndiheni shumë i vlerësuar.



**PESHQIT**  
Shijoni këtë ditë të lumtur, plot stimul

të rinj, tërheqës dhe perspektivë të favorshme! Me sfondin e muzikës romantike, mbrëmja do të jetë e këndshme.

## Shtyhet premiera e filmit të ri të James Bondit, shkak koronavirusi



**P**remiera e filmit më të ri të James Bondit është shtyrë për shtatë muaj teksa koronavirusi i ri vazhdon të përhapet. Producentët kanë thënë se e kanë bartur prezantimin e filmit “No Time To Die”, nga prilli në nëntor, “pas një shqyrtimi të kujdesshëm të gjendjes së tregut


global teatral”. Ky njoftim ka ardhur disa ditë pasi krijuesit e dy faqeve online që pëlqejnë filmat e James Bondit kanë bërë thirrje për shtyrje të datës së premierës. Në Britani të Madhe, data e re e premierës është 12 nëntori, ndërsa në Shtetet e Bashkuara 25 nëntori.

## Gigi Hadid në trendin e ngjyrave të tokës



**D**erisa po shkonte mes shfaqjeve gjatë Javës së Modës në Milano, modeluesja doli jashtë në një shembull të shkëlqyeshëm të stilit të rrugës. Ajo zgjodhi një bluzë të hollë-ton-bezhë nga COS që kushton më pak

se 60 euro. Për më tepër, Hadid e stilo bluzën në një mënyrë kaq miqësore në stilin e rrugës, duke e veshur atë me një kostum leshi ngjyrë bezhë dhe çizme të këmbës së cirkut, dhe pamja neutrale është fiks për 2020.



## Sophie Turner shtatzënë?

**S**ophie Turner dhe Joe Jonas u kanë hedhur edhe më shumë ‘benzinë’ thashethemeve për një shtatzëni të mundshme. Çifti janë parë duke blerë në një dyqan për fëmijë në Studio City të Kalifornisë, në mes të raportimeve se ylli i ‘Game of Thrones’ dhe

Jonas Brother janë në pritje të fëmijës të tyre të parë. Turner dukej shumë rehat, e veshur me rroba sportive nga Giants që i kishte kombinuar me atlete të bardha. Në ndërkohë, Jonas kishte zgjedhur të vishej i tëri me ngjyrë të zezë.

## Katy Perry zbulon përmes një videoklipi se është në pritje të një fëmije me Orlando Bloom



**S**uper ylli i popit, Katy Perry, ka zbuluar se ajo dhe i fejuari i saj Orlando Bloom janë në pritje të fëmijës së tyre të parë. Katy njoftoi për shtatzëninë në videoklipin e këngës së saj të fundit, “Never Worn White”. Perry, e cila më parë ishte e martuar me

Russell Brand, është në një lidhje me Bloomin që nga viti 2016. Perry u tha fansave se ata ishin të ngazëllyer dhe të lumtur, që ardhja e fëmijës së tyre po vjen me albumin e saj të gjashtë. “Ka shumë që do të ndodhin këtë verë”, ka deklaruar ajo.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT Pilkington  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Vetëm humbja e papranueshme për Kosovën kundër Rusisë

Futbollistet “dardane” kanë mbajtur edhe stërvitjen e fundit para ndeshjes kualifikuese kundër Rusisë e cila zhvillohet sonte (e premte) në Wiesbaden të Gjermanisë. “Synimi ynë është për një paraqitje sa më të mirë dhe për rezultat pozitiv, por jemi të vetëdijshme për cilësitë e kundërshtarëve”, ka thënë Afërdita Fazlija, përzgjedhëse e Kosovës



kualitetin e juaj si futbolliste, andaj besoj se të premten do të kemi një paraqitje të mirë”, ka deklaruar Ademi.

Ndërsa futbollistet Edona Kryeziu dhe Valentina Limani kanë shfaqur optimizëm se Kosova mund të marrë rezultat pozitiv ndaj Rusisë. “Mendoj se do të jetë një lojë shumë e vështirë ngaqë të dyja ekipet synojnë fitoren. Nuk e njohim shumë kundërshtarin, por në bazë të asaj çfarë kemi parë, shihet se ka cilësi”, ka thënë Limani. “Ne i njohim cilësitë e kundërshtarit, por asnjëherë nuk do ta respektojmë më shumë sesa duhet. Jemi shumë të motivuara dhe do ta japim maksimumin që të marrim pikë nga ky takim. Pres që në këtë përballje të vështirë me ruset ta kemi edhe përkrahjen e tifozëve - bashkatdhetarëve tanë në Gjermani”, ka deklaruar Kryeziu.

**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 5 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave sonte (e premte) nga ora 18:00 e zhvillon ndeshjen kualifikuese për “Euro 2021” kundër Rusisë në Gjermani. Vendimin për t'u zhvilluar ndeshja në shtetin gjerman e ka marrë UEFA, pasi Rusia nuk e njeh Pavarësinë e Kosovës. Përzgjedhësja e Kosovës, Afërdita Fazlija, ka thënë se në

këtë ndeshje synohet rezultat pozitiv. “Synimin ynë është për një paraqitje sa më të mirë dhe për rezultat pozitiv, por jemi të vetëdijshme për cilësitë e kundërshtarëve”, ka thënë Fazlija. Përfaqësuesen në Wiesbaden e kanë vizituar drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës, kryetari Agim Ademi, nënkryetari Bakir Burri, anëtarja e KË-së, Vjollca Krasniqi, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu dhe trajneri i Përfaqësueses A,

Muharrem Sahiti. “Tashmë ju e keni krijuar një grup homogjen dhe jeni të vetëdijshme për rëndësinë që e ka fanella e përfaqësueses. Në ndeshjet e deritashme keni dëshmuar se sa me krenari e bartni këtë fanellë, andaj ne presim nga ju që të lini përshtypje sa më të mira edhe në vazhdim të këtij kompeticioni”, ka thënë kryetari i FFK-së, Agim Ademi. “Ju inkurajoj të luani lirshëm e pa

presion, pa marrë parasysh forcën e kundërshtarit që do të keni përballë. Duhet ta ruani qetësinë dhe të luftoni maksimalisht për rezultate sa më të mira. Nuk kërkojmë nga ju që të jeni liderë të grupit, por duam ta vazhdoni ngritjen jo vetëm nga ana organizative, por edhe nga ana profesionale. Kam besim te puna e shtabit teknik e përfaqësueses dhe e vlerësoj shumë përkushtimin dhe

## ‘Toki’ rikthehet te Feronikeli

Afrim Tovërlani është rikthyer në Klubin e Feronikelit pas trofeve të fituara në sezonet 2014/15 dhe 2015/16. “Toki” është ndër trajnerët më të suksesshëm në futbollin e Kosovës

**“Epoka e re”**

**PRISHTINË, 5 MARS** - Skuadra kampione në fuqi e Kosovës në futboll, Feronikeli, një ditë pas humbjes nga Gjilani në Superligë, e ka prezantuar trajnerin e ri Afrim Tovërlani. Për “Tokin” kjo nuk është hera e parë që e drejton skuadrën nga Drenasi, pasi një gjë të tillë e kishte bërë edhe në të kaluarën.

Trajneri i njohur në futboll e Kosovës, Afrim Tovërlani, edhe zyrtarisht është emëruar trajner i skuadrës së Feronikelit. “Afrim Tovërlani, i njohur për publikun si ‘Toki’, është ndër trajnerët më të trofeshëm të Superligës së Kosovës dhe po rikthehet në skuadër pas trofeve të fituara në sezonet 2014/15 dhe 2015/16. Tovërlani ka lindur në Prishtinë më 17 janar 1967 dhe pati një karrierë të bujshme si futbollist,



me FC Prishtinën e KF Flamurtarin. U paraqit edhe me Përfaqësuesen e Kosovës, në ndeshjen e vitit 1993, në miqësoren ndaj Shqipërisë, ani

pse atëbotë e cilësuar si ndeshje jozyrtare”, thuhet në njoftimin e Feronikelit. Tovërlani në skuadrën e Feronikelit e zëvendëson Agim

Sopin, i cili me marrëveshje të dyanshme e shkëputi kontratën me klubin elitare të Kosovës. Afrim Tovërlani është i njohur në zejen e trajnerit. Ai ka fituar gjithsejtë gjashtë trofe në Kosovë. Ai u shpall kampion i Kosovës tri herë me FC Prishtina gjatë sezoneve: 2007/08, 2008/09 dhe 2012/13. Po ashtu, me FC Prishtina ai fitoi edhe Kupën e Kosovës gjatë sezonit 2012/13. Tovërlani merr FC Feronikelin me gjendjen aktuale në tabelën e IPKO Superligës së Kosovës, me 31 pikë, në vendin e 5-të. Ndërsa, në DigitAlb Kupën e Kosovës, FC Feronikeli gjendet në gjysmëfinale të kësaj gare, si kundërshtar i FC Ballkanit.

## Drenica fiton derbin kuqezi, Dukagjini lëshon fitoren nga duart

**Prishtinë, 5 mars (ER)** - Dy ndeshjet e fundit të javës së 21-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të enjten. Skuadra e Drenicës e ka fituar derbin e skuadrave kuqezi ndaj Flamurtarit të Prishtinës me rezultat 3-1. Alban Shillova realizoi dy gola në pjesën e parë ndaj ish-skuadrës së tij, kurse një tjetër e shtoi në pjesën e dytë Hasan Hyseni. Për mysafirët realizues ishte kapiteni Veton Kabashi. Pas kësaj ndeshje

Drenica ngritet në vendin e shtatë me 27 pikë, kurse Flamurtari bie në pozitën e nëntë me 25 pikë. Ndeshja tjetër në mes të Vushtrrisë dhe Dukagjinit nga Klina ishte dramatike dhe në fund përfundoi baras (3-3). Mysafirët kishin epërsinë prej dy golash, por në fund është dashur të pajtohen me një pikë. Shënues për Vushtrrinë në këtë ndeshje ishin Salinas, Sie dhe Bler Istrefi, kurse për Dukagjinin dy gola i realizoi Leorant Marmullaku dhe



një tjetër e shtoi Jeton Dushi. Këto dy skuadra renditen në pozitë e

fundit në tabelë me 16 pikë, përkatësisht 10 pikë.

**IPKO SUPERLIGA - Java e 21-të**

|                       |     |
|-----------------------|-----|
| Drenica - Flamurtari  | 3-1 |
| Vushtrria - Dukagjini | 3-3 |
| Ballkani - Drita      | 2-0 |
| Gjilani - Feronikeli  | 2-1 |
| Trepça '89 - Llapi    | 1-2 |
| Prishtina - Ferizaj   | 3-2 |

**Tabela**

|               |    | <b>Pikë</b> |
|---------------|----|-------------|
| 1. Ballkani   | 21 | 44          |
| 2. Gjilani    | 21 | 41          |
| 3. Prishtina  | 21 | 41          |
| 4. Drita      | 21 | 40          |
| 5. Feronikeli | 21 | 31          |
| 6. Llapi      | 21 | 31          |
| 7. Drenica    | 21 | 27          |
| 8. Trepça '89 | 21 | 26          |
| 9. Flamurtari | 21 | 25          |
| 10. Ferizaj   | 21 | 22          |
| 11. Vushtrria | 21 | 16          |
| 12. Dukagjini | 20 | 10          |

## Jashanica rikthehet pas dy vjetësh: Golin ia dedikoj familjes

**KORÇË, 5 MARS** - Rikthim pas dy vjetësh para tifozëve korçarë dhe gol ndaj Luftëtarit. Bajram Jashanica është ambientuar më shpejt nga sa mendohej, duke treguar se do të jetë ai lideri i mbrojtjes korçare. Goli ishte më i bukuri dhe më i rëndësishmi për

mbrojtësin kosovar të Skënderbeut. “Nuk e kisha menduar kështu rikthimin për të qenë i sinqertë. Një paraqitje e mirë në Shkodër dhe një gol tani do të thonë shumë për mua. Jam i gëzuar fillimisht për ekipin që po vijon me paraqitjet pozitive

dhe për rezultatet që po arrijmë në këto ndeshje. Nuk di çfarë të them, për mua është një rikthim i ëmbël. Pas golit, nuk dija si të festoja, pasi nuk e prisja të shënoja. Megjithatë, kur pashë që topi shkoi në rrjetë, ishte si një çlirim dhe mendova si të fes-

toja më pas. Mirëpo, shokët e ekipit nuk më lanë pasi m'u hodhën sipër. Për mua ky është një tregues i rëndësishëm i unitetit në grup. Këtë gol ia dedikoj familjes sime për të gjitha vuajtjet që kanë kaluar dhe mbështetjen që më kanë dhënë.



Falënderoj edhe klubin, trajnerin dhe shokët e ekipit, që më janë gjendur pranë si një familje e madhe”, deklaroi Jashanica për “Panorama Sport”.

## Sahiti: Futbollistët do ta japin maksimumin ndaj Maqedonisë

**PRISHTINË, 5 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të luajë një prej ndeshjeve më të rëndësishme në histori, atë në kuadër të gjysmëfinales së “play-off”-it në Ligën e Kombeve kundër Maqedonisë së Veriut. Sa më shumë që po kalojnë ditët, emocionet për këtë ndeshje po shtohen bashkë me entuziazmin dhe dëshirën e “dardanëve” që ta sigurojnë kualifikimin në një ngjarje të madhe të futbollit evropian.



Ndihmëstrajneri i Përfaqësueses së Kosovës, Muharrem Sahiti, në një intervistë për “KosovaPress” fillimisht foli për përgatitjet që stafi i përfaqësueses ka bërë deri më tani. Sipas tij, Kosova është e gatshme për përballjen ndaj Maqedonisë, ndërsa përgatitjet për këtë ndeshje kanë nisur qysh nga ndeshja e fundit, që “dardanët” kanë zhvilluar ndaj Anglisë. “Sa më shumë që po afrohet koha e ndeshjes aq më shumë po kemi angazhime rreth përgatitjes së përfaqësueses. Në fakt, përgatitjet kanë filluar nga ndeshja e fundit e kualifikimeve që patëm me Anglinë duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj ndeshje. Pra, jemi duke përcjell jo vetëm lojtarët tanë, por edhe kundërshtarin, paraqitjen e tij”, ka thënë Sahiti, i cili ka shtuar se e rëndësishme është që futbollistët po kanë

minuta të duhur në skuadrat e tyre, andaj edhe forma e tyre është në rritje. “Gjithmonë ne varem nga performanca e lojtarëve nëpër klube. Forma e tyre fizike është jashtëzakonisht e mirë. Ne jemi të kënaqur me paraqitjen e tyre”, ka shtuar ai. Duke ditur se Maqedonia është një kundërshtar tejet e fortë për Kosovën, Sahiti u shpreh se së bashku me stafin e përfaqësueses kanë analizuar çdo detaj të kundërshtarit, në mënyrë që Kosova të jetë më e përgatitur fizikisht dhe emocionalisht për këtë ndeshje të rëndësishme. “Po, është një skuadër që nuk duhet nënçmuar. Kemi lojtarë që luajnë nëpër klube jashtëzakonisht të organizuara. Lojtarët kryesorë po kanë kohë të lojës mjaftueshëm, por besoj se në këtë ndeshje nuk do të vendosë vetëm kualiteti, por

edhe faktorë të tjerë. Kështu që mund të them se faktori i motivimit mund të ndikojë edhe më shumë. Ne kemi një përfaqësuese shumë të bashkuar”, ka deklaruar Sahiti. Sa i përket një parashikimi të mundshëm për këtë ndeshje, ndihmëstrajneri i Kosovës u shpreh se është vështirë për një gjë të tillë, duke parë edhe formën aktuale të dy përfaqësueseve. “I vështirë parashikimi por, sidoqoftë, ne do të përgatitemi për ta fituar ndeshjen. Këta djem më 26 mars do të bëjnë gjithçka për të arritur rezultat pozitiv”, ka përfunduar Sahiti. Ndeshja Maqedoni - Kosovë zhvillohet më 26 mars, me fillim nga ora 20:45, në stadiumin e qytetit në Shkup, ndërsa fituesi i kësaj ndeshje do të luajë në finale me fituesin e ndeshjes tjetër Gjeorgji - Bjellorusi.

## Milwaukee u rikthehet fitoreve në NBA

**MILWAUKEE, 5 MARS** - Milwaukee rikthehet te fitorja në NBA, duke mundur me lehtësi 119-100 Indianan, fitore që ishte një formalitet për Bucksin, skuadra më rekordin më të mirë këtë sezon në kampionat. Suksesi i 53-të për Milwaukee mban firmën e Giannis



Antetokounmpo, që realizoi 29 pikë e 12 rebounde, më i miri në parket. Fitore në momentet e fundit për Miamin, që e mposhti me rezultat 116-113 Orlandon, sfidë e ekuilibruar, ku për Heat u dalluan Roboston me 27 pikë e Dragiqi me 25 pikë, raporton “Telesport”. Një

moment të mirë po kalon Utah Jazzi, që mposhti me shifrat 112-104 New Yorkun dhe qëndron mes skuadrave elitare në Perëndim. 30 pikët e 11 reboundet e Rundle për New Yorkun mbetën për statistikë, ndërsa pas Jazzit u dalluan Bogdanoviqi e Mitchell, me nga 23 pikë secili. Pas kohës shtesë fiton Dallasi, që mposhti me rezultat 127-123 New Orleansin. Porzingisi realizoi 34 pikë e 12 rebounde, ndërsa Donqiqi e mbylli me një “triple double” (30 pikë, 17 rebounde e 10 asistime).

### SHKURT

#### Lazio kërkon Muriqin

Lazio po konsideron sërish mundësinë për ta sjellë në afatin kalimtar të verës sulmuesin e Kosovës, Vedat Muriqi. “Corriere dello Sport” shkruan se klubi “bardhekaltër” ka përcaktuar se në rast se nuk arrijnë ta afrojnë sulmuesin e Chelseat dhe Francës, Oliver Giroud, të cilit i skadon kontrata me “Blutë”, atëherë do t'i nisin lëvizjet për ta finalizuar transferimin e sulmuesit shqiptar. Vlera e kartonit të tij shkon mbi 30 milionë euro dhe falë 15 golave të shënuara deri tani me Fenerbahçen, drejtuesit e Lazios e çmojnë si të rëndësishëm Muriqin.

#### PSG-ja lëshon Neymarin për Griezmannin

PSG-ja është e gatshme të heqë dorë nga Neymari dhe të mbajë në skuadër Mbappen, raporton e përditshmja spanjolle “Sport”. Ylli francez kërkon të jetë ai në qendër të projektit të klubit dhe, me sa duket, drejtuesit kanë vendosur t'ia plotësojnë këtë dëshirë. Mes palëve pritet të diskutohen kushtet e reja të kontratës e cila do ta shndërrojë Mbappe në lojtarin më të paguar në botë, 50 milionë euro në sezon. I ndryshëm diskuti-mi për Neymarin, braziliani mund të rikthehet te Barcelona por, sipas kushteve të PSG-së. Francezët kërkojnë shërbimet e Griezmannit, në mënyrë që t'i bashkojnë në Paris dy kampi-onët e botës, Griezmann-Mbappe.

#### Ronaldinho arrestohet në Paraguai

Ish-futbollisti më i mirë në botë, Ronaldinho, është arrestuar në Paraguai pasi u ka treguar autoriteteve një pasaportë false, shkruan “La Nacion”. 39-vjeçari që ka fituar Kupën e Botës me Brazilin në vitin 2002 është arrestuar në resortin “Yacht & Golf Club Paraguayo” së bashku me vëllanë e tij, Robertson, të mërkurën mbrëma, ka konfirmuar Ministria e Brendshme e Paraguait. Pasaportat janë gjetur në hotel me emrat e Ronaldinhos dhe Robertos, por me nacionalitet të Paraguait. Raportohet se Ronaldinho është ftuar nga pronari i kazinos, Nelson Belotti. Ai është pritur të mbajë disa evenimente publike. Ronaldinho aktualisht është pa pasaportë, pasi i është konfiskuar pasaporta nga autoritetet braziliane për shkak të një rasti gjyqësor në të cilin është i përfshirë për shkelje të rregullave të ambientalizmit. Ronaldinho dhe vëllai i tij janë dënuar për ndërtim jo të ligjshëm në pronën e tyre në liqenin Guaiba në vitin 2015. Ata janë gjobitur 8.5 milionë dollarë në nëntor të vitit 2015 dhe pasi nuk kanë paguar, Gjykata Supreme e Drejtësisë në Brazil ka vendosur t'ua konfiskojë pasaportat.

#### Nadali thyen një rekord në tenis

Tenisti spanjoll Rafael Nadal triumfoi pak ditë më parë në turneun e Accapulco (Meksikë), suksesi i parë sezonal për 34-vjeçarin. Ky triumf pa një të veçantë për Nadalin, pasi e bën atë një legjendë në sportin e tenisit. Ai është tenisti i vetëm që arrin të fitojë të paktën një trofe në vit prej 17 sezonesh radhaz. Askush tjetër nuk ka arritur të jetë fitues për një periudhë kaq të gjatë. Madje as Federeri që ka fituar të paktën një turne për 15 sezona radhazi, ashtu sikurse Novak Djokoviq. Spanjolli ka mundësi që ta thyejë edhe më tej këtë rekord nëse vazhdon të luajë edhe vitin tjetër e natyrisht nëse arrin të jetë i suksesshëm. Nadali ka shumë avantazh në fushat me dhe, që është sipërfaqja e tij e preferuar e ku fiton thuajse në të gjitha turnetë ku merr pjesë. Renditja: Rafael Nadal (17 sezona), Roger Federer (15 sezona), Novak Djokoviq (15 sezona), Ivan Lendl (14 sezona), Jimmy Connors (13 sezona).

#### REZULTATET

|                       |         |
|-----------------------|---------|
| Cleveland - Boston    | 106-112 |
| Detroit - Oklahoma    | 107-114 |
| Milwaukee - Indiana   | 119-100 |
| Brooklyn - Memphis    | 79-118  |
| Miami - Orlando       | 116-113 |
| New York - Utah Jazz  | 104-112 |
| Minnesota - Chicago   | 115-108 |
| Dallas - New Orleans  | 127-123 |
| Portland - Washington | 125-104 |

|                                                                                     |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   |                                                           |                                                                           |                                                                        |                                     |                                                         |                                                               |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|
|   | <b>Autor:</b><br><b>GAZMEND MORINA</b>             |      | GAZETA QË<br>PO E MBANI<br>NË DUAR                      | NJOLLA                                                                             | KËNGËTARI<br>ANGLEZ<br>KLEPTON                    | AJKA E<br>QUMËSHITIT                                                 | ELIZA<br>DUSHKU                                                   | QË IA PRET<br>MENDJA;<br>I SHKATHËT                       | BASHKËT.                                                                  | <b>EPOKA<br/>ERE</b>                                                   | ABBOTT<br>MEDICAL<br>OPTICS         | MJET SHPËR-<br>THYES<br>(sh.shq.)                       | BISHË MALI                                                    |
|                                                                                     | SECILA NGA<br>PJESËT QË<br>FORMOJNË<br>NJË TË TËRË |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   |                                                           |                                                                           | GURRA<br>PARIA E<br>SHOQËRISË                                          |                                     |                                                         |                                                               |
|                                                                                     | PARAKALIMI<br>I TRUPAVE<br>USHTARAKE               |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   |                                                           | PRINC ARAB<br>EMRI I KOMAN-<br>DANTIT<br>LEGJENDAR<br>TË UÇK-së<br>(shq.) |                                                                        |                                     |                                                         |                                                               |
|                                                                                     | LLOJ BIME ME<br>TË CILËN<br>BËJMË PILAF            |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      | TRISKA,<br>KUPONI                                                 |                                                           |                                                                           |                                                                        |                                     |                                                         |                                                               |
|                                                                                     | FUTBOLLIST<br>I NJOHUR<br>BRAZILIAN<br>(MILAN)     |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      | MODERATORI<br>KRASTA<br>SHKOPI I<br>BILARDOS                      |                                                           |                                                                           |                                                                        | DY ZANORE<br>KËNGËTARE E<br>JONA    |                                                         |                                                               |
|                                                                                     | ZANORE                                             |      |                                                         | TËRËSIA E<br>LËVIZJEVE TË<br>PJESËVE TË<br>FYTYRËS                                 | ZANORE                                            | SHKRIHET<br>NË UJË<br>SMIRË, ZILI                                    |                                                                   |                                                           |                                                                           |                                                                        |                                     |                                                         | MBUSHJE<br>ME BETON                                           |
|                                                                                     | MODELJA<br>ÇUNMULAJ                                |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | PYLL<br>SINDH<br>REVENUE<br>BOARD                         |                                                                           |                                                                        |                                     | BASHKËT.<br>DRITËRO<br>AGOLLI                           |                                                               |
| <b>EPOKA<br/>ERE</b>                                                                |                                                    | FOTO | ZBËRTHIM I<br>NJË ÇËSHTJE                               | FAJDEXHI                                                                           | KËNGËTARJA<br>... KOÇI                            | HISTORIANI<br>ROMAK LUK-<br>RECI                                     | E KËPUTUR;<br>E MPAKUR<br>ISMET<br>MUNISHI                        |                                                           |                                                                           | KOHË BREN-<br>DA SË CILËS<br>DUHET TË<br>KRYHET NJË<br>PUNË<br>KOPJIMI |                                     |                                                         |                                                               |
| MODEL I ZVO-<br>GËLUAR I<br>NJË NDËRT-<br>ESE (shq.)                                |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | AKTORJA E<br>VJETËR<br>... RINA                           |                                                                           | FOLTORJA<br>SHTRESA E<br>SIËPRME E<br>AJRIT                            |                                     |                                                         | ZANORE<br>I PËSHPËRIT<br>DIKUJT FJALË<br>MAGJIKE              |
| I NJËZËSHËM                                                                         |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | PJESË E<br>FORTË E<br>BUKËS<br>FATKEQËSI E<br>MADHE, KOB; |                                                                           | HUMANISTI<br>BIÇIKEMI<br>SHKRONJA<br>TË NJËJTA                         |                                     |                                                         |                                                               |
| FUTBOLLISTI<br>ALTINTOP                                                             |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      | NJË E HAPUR<br>E NJËRËS<br>KËMBË PARA<br>SHKRONJA<br>XXXII & VIII |                                                           |                                                                           | POLITIKANI<br>SHEHU (shq.)<br>NEON                                     |                                     |                                                         |                                                               |
| ALUMIN,<br>AMPER                                                                    |                                                    |      |                                                         |                                                                                    | DEGË E<br>MJEKËSISË                               | PAMELA<br>ANDERSON<br>KËNGË<br>DJEPI                                 |                                                                   |                                                           | E PLOGËT                                                                  |                                                                        |                                     | ALYSSA<br>MILANO<br>ZANORE                              |                                                               |
| VESSHJE E<br>SIPËRME PREJ<br>SHAJAKU<br>(sh.shq.)                                   |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | KA, DEM<br>PËRKUFIZIMI                                    |                                                                           | KRYEHOXHË<br>RITUAL                                                    |                                     |                                                         | RRUGË QË<br>BËN TOPI KUR<br>I KALOHE<br>NJË LOJTARI<br>TJETËR |
| THIRRJA E<br>MYEZINIT                                                               |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   | ANIMAL<br>DEMOGRAPHY<br>UNIT<br>ARMATA<br>IRLANDEZE<br>(shk. origj.) |                                                                   |                                                           | KËNGËTARJA<br>LIBOHOVA<br>MBAJTJA<br>E ANËS                               |                                                                        |                                     | ANTON PAS-<br>HKU<br>PARIMET                            |                                                               |
| DESPOTI                                                                             |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      | FRYMA<br>PËREMËR<br>VETOR                                         |                                                           |                                                                           | SHKRONJA<br>TË NJËJTA<br>OMANI,<br>JEMENI                              |                                     | KANSAS<br>TURNPIKE<br>AUTHORITY<br>GJERMANI I<br>VJETËR |                                                               |
| MIMOZA<br>MUSTAFA                                                                   |                                                    |      |                                                         | ANË E<br>NJERËZVE<br>TË NJË FISI<br>LIBRI PËR<br>MBAJTJEN E<br>SHËNIMEVE<br>DITORE |                                                   |                                                                      |                                                                   |                                                           | SPORT UJI                                                                 |                                                                        | KLUB FUT-<br>BOLLI<br>GREK<br>PUSIA |                                                         |                                                               |
| ZANORE                                                                              |                                                    |      | AKTORI<br>QOSJA (shq.)<br>ISH PRESI-<br>DENTI<br>RONALD |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | ISMET JAS-<br>HARI<br>KËNGËTARJA<br>..... MIMANI          |                                                                           | QELESHJA<br>ZANORE                                                     |                                     |                                                         |                                                               |
| ZGAVËR NË<br>TOKË (shq.)                                                            |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   | EMËR I VJET-<br>ËR PËR VIET-<br>NAMIN<br>NIS TË<br>ZBARDHË<br>DITA   |                                                                   |                                                           | IRNOSET<br>(bised.)<br>SOKOL BAS-<br>HOTA                                 |                                                                        |                                     | BASHKËT.<br>LLOJ LULEJE                                 |                                                               |
| PJESË E<br>SYRIT                                                                    |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      | PREZANTUE-<br>SJA SHQIP-<br>TARE ....<br>GJONI<br>NEGRI, ZEZAK    |                                                           |                                                                           | EMËR YNI<br>MASHKULLI<br>SHAJAK I<br>HOLLË E I<br>RRAHUR MIRË          |                                     |                                                         | GOTË PREJ<br>METALI                                           |
| TITULL OTO-<br>MAN                                                                  |                                                    |      |                                                         |                                                                                    | POETI<br>VINCA (shq.)<br>DY BASHKË-<br>TINGËLLORE |                                                                      |                                                                   |                                                           | E SHTËNË ME<br>DISA ARMË<br>ZJARRI<br>NJËHERËSH<br>(sh.shq.)<br>"IRLANDA" |                                                                        |                                     |                                                         |                                                               |
| MASË GJATË-<br>SIE QË PËR-<br>DORET NË<br>DISA VENDE E<br>BARABARTË<br>ME 91, 44 CM |                                                    |      |                                                         |                                                                                    |                                                   | FUTBOLLISTI<br>MESUT ....<br>(shq.)<br>OHIO                          |                                                                   |                                                           |                                                                           | APARTAMENTI<br>BASHKËT.                                                |                                     |                                                         |                                                               |
| <b>EPOKA<br/>ERE</b>                                                                | AKTORI<br>MUÇAJ<br>(shq.)                          |      |                                                         |                                                                                    |                                                   |                                                                      |                                                                   | KËNGËTARJA<br>BAJRAMI                                     |                                                                           |                                                                        |                                     | INTENSITET,<br>TANTAL, SUL-<br>FUR                      |                                                               |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agencija za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency  
Sektori i Burimeve Njerëzore  
Sektor ljudskih resursa  
Human Resources Sector

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-212 , të Punës, UA (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin publik, Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës; Ligjit Nr.03/L-153 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës bënë:

SHPALJEN E KONKURSIT PËR KËTË VEND PUNE

|                           |                                                                 |
|---------------------------|-----------------------------------------------------------------|
| Titulli i pozitës:        | Punëtor sezonal në mbjelljen dhe mirëmbajtjen e fidanëve        |
| Ref:                      | APK-01/20-LP                                                    |
| Njësia organizative:      | Drejtorati per Hulumtime, Projektme dhe Prodhim Fidanor në Pejë |
| Vendi i punës :           | Pejë, Fidanishte Arabërd (15),                                  |
| Nëpunësi Mbikëqyrës:      | Tekniku në Fidanishte                                           |
| Pagesa:                   | Kategoria Mallëra dhe Shërbime                                  |
| Paga neto :               | 250.00€                                                         |
| Lloji i pozitës së punës: | Kontratë për Punë dhe Detyra Specifike 120 ditë (4) muaj,       |

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përpunimi i tokës për mbjelljen e fidanëve,
- Punimi i lerrave,
- Hedhja e farës nëpër lera dhe mbulimi i saj,
- Lerrja e barojave nga lerrat,
- Dezinjektimi i kasetave për mbjelljen e fidanëve,
- Mbushja e kasetave me humus,
- Hedhja e farërave në qelitë e kasetave dhe mbulimi i tyre me humus,
- Bartja e kasetave dhe renditja e tyre,
- Ujitja e fidanëve,
- Mbrojtja e fidanëve nga sëmundjet (trajtimi i tyre me preparate kimike),
- Nxjerrja e fidanëve dhe numërimi i tyre,
- Përgatitja e fidanëve për transport,
- Kryen edhe punë tjera në domenin e punëve dhe detyrave në bazë të urdhrave që pranohet nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë-Tekniku në Fidanishte,

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Një (1) vjet përvojë pune në pylltari apo bujqësi ( është përparësi)
- Aftësi për punë ekipore dhe motivim të ekipit,
- Zotësi për punë në mjedise shumëmiqe,
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar procedurë hetimore penale.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

Shkolla e mesme e pylltarisë, bujqësisë ose shkollim tjetër të mesëm relevant

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur për të gjithë të interesuarit.

Data e shpalljes së konkursit: 06.03.2020

Data e mbylljes së konkursit: 20.03.2020

Dokumentacioni i nevojshëm i cili i bashkëngjitet aplikacionit:

- Certifikata e lindjes,
- Diploma mbi përgatitjen profesionale,
- Dëshmia për përvojën e punës,
- Dëshmia mbi trajnimet e kryera,
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale nuk zhvillohet procedurë hetimore penale,
- Fotokopja e letërnjoftimit (duhet të jetë e lexueshme),
- Fotokopja e kartelës bankare (duhet të jetë e lexueshme).
- Dokument nga MPMS që dëshmon se nuk ka të themeluar madhënie pune ( është i lamëruar si punëkërkesë ).

Bazuar në nenin 8 paragrafi 2 i Ligjit nr.03/L-212 të Punës Konkursi është i hapur pa asnjë lloj diskriminimi për të gjithë të interesuarit.

**Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen. Dokumentet dhe dëshmitë duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.**

**Procedura e Aplikimit:** Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Zyrën e Personelit dhe Zhvillimit të Burimeve Njerëzore , zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut Kombëtar të Kosovës) apo në Drejtoratin për Hulumtime, Projektme dhe Prodhim Fidanor në Pejë.

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 dhe 039-433-281, çdo ditë pune prej orës 8.<sup>00</sup> deri 16.<sup>00</sup>.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
